



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. regjistri 8/2024 (JR)  
Datë 06.03.2024

Vendim nr. 43 (JR)  
Datë 19.09.2024

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelitit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Ina Rama</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 19.09.2024, ditën e enjte, në orën 14:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelitit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar z. Ferdinando Buatier de Mongeot, me sekretar gjyqësor Kevin Kovaçica, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Komisionerja Publike Irena Nino.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 729, datë 10.01.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelitit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), analizoi pretendimet e ngritura nga Komisionerja Publike Irena Nino në ankim dhe në konkluzionet përfundimtare, nëpërmjet të cilave ajo kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 729, datë 10.01.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Zena Lila, e pasi analizoi parashtrimet edhe kërkimin e subjektit të rivlerësimit, i cili kërkoi lënien në fuqi të

vendimit të Komisionit, dëgjoji gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Zena Lila (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ushtronte detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe, për shkak të parashikimeve të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex-officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) administroi raportet e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

2.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit të pasurisë, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë<sup>1</sup> së subjektit të rivlerësimit, znj. Zena Lila, duke konkluduar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin financiar të pasurive; (iii) ka mosdeklarime të pasurive ndër vite; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2. DSIK-ja vuri në dispozicion të Komisionit raportin për kontrollin e figurës<sup>2</sup>, për subjektin e rivlerësimit, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Zena Lila.

2.3. KLP-ja i dërgoi Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale<sup>3</sup> për subjektin e rivlerësimit, znj. Zena Lila. Ky raport është hartuar nga KLP-ja bazuar në 5 dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, 3 dosjeve të dorëzuara nga vetë subjekti i rivlerësimit të dhënat nga burimet arkivore të KLP-së, si dhe të dhëna e indicie nga denoncimet lidhur me vendimmarrje të subjektit të rivlerësimit.

### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni e bazoi vendimmarrjen e tij në konkluzionet për secilin prej kriterëve të rivlerësimit, konkretisht si më poshtë.

---

<sup>1</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 03.12.2019, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë, të deklaratës së pasurisë së subjektit Zena Lila, me funksion prokurore pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”.

<sup>2</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 30.10.2017.

<sup>3</sup> Raporti i KLP-së nr. {\*\*\*} prot., datë 10.07.2023.

**3.1. Në lidhje me kriterin e pasurisë,** në analizë të përgjithshme, pasuria e subjektit të rivlerësimit përgjatë periudhës së rivlerësimit përbëhet nga një shtëpi e ndodhur në Selitë, një automjet tip “Ford Fusion” dhe një pasuri Bono Thesari në vlerën 3.860.000 (tre milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, e krijuar me kursimet e punës së pandërprerë prej vitit 1992 për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin e saj. Rezultati negativ financiar gjatë vitit 2005 për shkak të pretendimit, por mosprovimit të shumës 1.100.000 (një milion e njëqind mijë) lekë si e përfitur nga shitja e shtesave të shtëpisë në Gramsh, rezultati negativ në vitin 2007 dhe rezultati negativ gjatë viteve 2010 – 2016, që dukshëm ka ardhur për shkak të pasaktësive në deklarime e bëra ndër vite të kursimeve cash, në frymë të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk përbën shkak të qëllimshëm të penalizimit me masën disiplinore të shkarkimit sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në tërësi vlerësohet se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

**3.2. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës,** ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Zena Lila, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b”, të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

**3.3. Në lidhje me kriterin e aftësive profesionale,** nga analiza në tërësi e këtij kriteri rezultoi se subjekti ka arritur një nivel të kënaqshëm, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016. Duke konsideruar faktin që znj. Zena Lila ka një karrierë të gjatë në sistem dhe ndaj saj në Komision ka pasur vetëm një denoncim shkresor, në vlerësimin tërësor për Komisionin, kjo përbën tregues të një pune të bërë në përgjithësi me përgjegjshmëri, pa konfliktime apo pakënaqësi prej viktimave apo denoncuesve.

4. Në përfundim, Komisioni, bazuar në pikën 5, të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, duke çmuar se subjekti: (i) ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; (ii) ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; (iii) ka arritur një nivel të kënaqshëm kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në bazë të nenit 58, pika 1, shkronja “a” dhe nenit 59, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur:  
*Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Zena Lila, me funksion prokurorë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan [...].*

### **III. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik**

5. Komisionerja Publike Irena Nino ka paraqitur në Kolegj ankim<sup>4</sup> kundër vendimit të Komisionit nr. 729, datë 10.1.2024, i cili ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, znj. Zena Lila.
6. Komisionerja Publike, mbështetur në kompetencën kushtetuese dhe ligjore, ka konstatuar se vendimi nr. 729/2024 është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.
7. Referuar përmbajtjes së ankimit të Komisioneres Publike, rezulton se çështjet e ngritura prej saj adresohen në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë, të cilat paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

---

<sup>4</sup> Ankim i Komisioneres Publike nr. {\*\*\*} prot., datë 23.02.2024, protokolluar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 23.02.2024.

**8. Për pasurinë shtëpi banimi e përbërë nga dy dhoma, një kuzhinë, me sipërfaqe 99,9 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, {\*\*\*}, Selitë, Tiranë, Komisionerja Publike ka konstatuar se:**

**8.1.** Lidhur me burimin e deklaruar për këtë pasuri në deklaratën *vetting*, *shitja e një magazine*, *sipërfaqe ndihmëse*, *pjesë toke pa dokumentacion në vlerën totale 1.100.000 lekë*, Komisioneres Publike i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit e deklaroi këtë shumë si burim krijimi për herë të parë në deklaratën *vetting* dhe nga aktet nuk rezultoi të ketë paraqitur ndonjë dokumentacion justifikues mbi posedimin e kësaj pasurie dhe të ardhurat e pretenduara të përfituara.

**8.2.** Komisionerja Publike ndan të njëjtin qëndrim si Komisioni *se nuk ka rrethana që mund të dokumentojnë ekzistencën e shitjes së 200 m<sup>2</sup> truall, së bashku me sipërfaqe ndërtime të paregjistruara dhe përfitimin e vlerës 1.100.000 lekë, në vitin 2005. Vetëm deklarimi i depozitës, me vlerë 2.300.000 lekë, në DPV-në 2004, me burim shitjen e shtëpisë, është i pamjaftueshëm në kuptim të vlerës së provës për të argumentuar ekzistencën e këtyre sipërfaqeve dhe vlerën e pretenduar prej 1.100.000 lekësh për shitjen e tyre dhe vlerëson se pretendimet e subjektit nuk u provuan me dokumentacion edhe pas riçeljes së hetimit administrativ.*

**8.3.** Në përfundim, për këtë pasuri, Komisionerja Publike vlerëson se burimi i deklaruar i të ardhurave prej 1.100.000 lekësh i deklaruar vetëm në deklaratën *vetting*, si burim krijimi për pasurinë shtëpi banimi e përbërë nga dy dhoma, një kuzhinë, me sipërfaqe 99,9 m<sup>2</sup>, ndodhur në adresën {\*\*\*}, Selitë, Tiranë, mbeti në nivel deklarativ dhe i paprovuar me dokument shoqëruar, për rrjedhojë këto të ardhura, sipas Komisioneres Publike, nuk e kalojnë testin e provueshmërisë e, për pasojë, edhe testin e ligjshmërisë së tyre.

**9. Lidhur me depozitën bankare në Bankën e Shqipërisë, Bono Thesari në vlerën 3.860.000 lekë, Komisionerja Publike nuk ndan qëndrim dhe vlerësim të njëjtë me Komisionin, pasi përpos sa ka paraqitur në ankim mbi mospërfshirjen në mesin e burimeve të ligjshme të shumës prej 1.100.000 lekësh, e pretenduar si e ardhur nga shitja e pasurisë në vitin 2005 (çka do të rezultonte pamjaftueshmëri financiare e këtij viti në të njëjtën shumë), në vlerësimin e Komisioneres Publike, pamjaftueshmëria financiare për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, për vitet e analizuara, do rezultonte e ndryshme nga pamjaftueshmëria e konstatuar nga Komisioni në funksion edhe të rivlerësimit të zërave: (i) shpenzime jetese për vitin 2007; dhe (ii) kursime *cash* ndër vite.**

**9.1.** Sipas Komisioneres Publike, rezultoi se Komisioni, në analizën financiare të vitit 2007, ka llogaritur shpenzimet e jetesës jo në përputhje me standardin e përdorur në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, bazuar në korrespondencën me ILDKPKI-në. Nga rishikimi i këtij zëri në analizën e vitit 2007, shpenzimet e jetesës do të rriteshin në vlerën 397.392 lekë dhe, po me të njëjtën vlerë, do të rritej dhe pamjaftueshmëria financiare e konstatuar nga Komisioni<sup>5</sup>, duke arritur një vlerë negative që nuk mund t'i nënshtrohet parimit të proporcionalitetit të parashikuar nga neni 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në përputhje me standardet e vendosura nga jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit.

---

<sup>5</sup> Diferenca në këtë rast do të shkonte në shumën (-) 2.081.201 lekë.

9.2. Komisionerja Publike, pasi konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë deklaruar në asnjë nga deklaratat periodike vjetore përdorimin e kursimeve *cash*, si burim për krijimin e likuiditeteve në llogaritë bankare, vlerëson se arsyetimi dhe trajtimi në vendimin objekt ankimi i kursimeve në *cash* të subjektit të rivlerësimit ndër vite nuk përputhet me gjendjen që janë aktet në dosje dhe bie ndesh me jurisprudencën orientuese dhe tashmë të konsoliduar të Kolegjit<sup>6</sup>. Në vlerësimin e Komisioneres Publike, analiza financiare e subjektit të rivlerësimit duhet kryer duke llogaritur për çdo vit kursimet në *cash* si shtesa të kursimeve dhe pa pakësuar kursimet e akumuluar në vitet e mëparshme, në përputhje me deklaratimet në deklaratat periodike vjetore.

9.3. Si rezultat i kryerjes së analizës financiare bazuar në argumentet e mësipërme, Komisioneres Publike i rezulton se përveç pamjaftueshmërisë financiare, konstatuar për krijimin e likuiditeteve në vitin 2005, në shumën (-) 1.100.000 lekë (likuiditete të cilat duket se janë tërhequr në vitin 2008 dhe kanë shërbyer për pagesën e këstit të parë të apartamentit), do të rezultonte dhe pamjaftueshmëri financiare për periudhën 2007-2016, në vlerën (-) 1.650.803 lekë<sup>7</sup>.

10. Në përfundim, Komisionerja Publike vlerëson se: (i) pamjaftueshmëria e konstatuar si më sipër me burimet e deklaruara të përdorura për krijimin e pasurisë apartament banimi, me sip. 99,9 m<sup>2</sup>; (ii) pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme në krijimin e depozitave të investuara në formën e bonove të thesarit dhe mbulimin e shpenzimeve të periudhës së analizuar, të dyja së bashku janë të tilla që e bëjnë deklarin e subjektit të rivlerësimit, për kriterin e kontrollit të pasurisë, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Komisionerja Publike kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit e të vendosë ndryshimin e vendimit nr. 729, datë 10.01.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Zena Lila.

#### IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

##### A. Mbi aspektet procedurale të gjyqimit

###### a) Juridiksioni i Kolegjit

Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të

---

<sup>6</sup> Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 11/2019 (JR); nr. 19/2019 (JR); nr. 20/2019 (JR) dhe nr. 27/2020 (JR).

<sup>7</sup> Diferencë që përbëhet prej: (-) 635.303 lekë, për vitin 2007, duke konsideruar shpenzime jetese sipas standardit të përdorur nga KPA, shtesë kursimesh *cash*, në shumën 500.000 lekë dhe shtesës së likuiditeteve në llogaritë bankare; (-) 76.717 lekë, për vitin 2008, duke konsideruar shtesë kursime në *cash* në vlerën 600.000 lekë; (-) 386.108 lekë, për vitin 2010, si rezultat i shtesës së gjendjes *cash* të vitit 2010, në shumën e deklaruar +400.000 lekë; (-) 112.503 lekë, në vitin 2011, si rezultat i pakësimit të kursimeve *cash* të vitit 2011, në shumën e deklaruar (-) 1.300.000 lekë; (-) 220.308 lekë, për vitin 2012, si rezultat i shtesës së gjendjes *cash* të vitit 2012, në shumën e deklaruar + 700.000 lekë; (-) 219.864 lekë, për vitin 2016, si rezultat i shtesës së gjendjes *cash* të vitit 2014, në shumën e deklaruar + 700.000 lekë.

vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit, znj. Zena Lila, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

#### *b) Legjitimimi i ankuesit*

Komisionerja Publike legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

#### *c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi nga Kolegji i ankimit ndaj vendimit nr. 729, datë 10.01.2024, të Komisionit, duke qenë se është ushtruar nga Komisionerja Publike, u zhvillua në seancë gjyqësore publike.

### **B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit nga Kolegji**

11. Trupi gjykues i Kolegjit mori në shqyrtim dhe ia nënshtroi analizës së tij shkaqet e ankimit, mbi të cilat u mbështet Komisionerja Publike, si arsye për të cilat duhej të vendosej ndryshimi i vendimit të Komisionit, objekt shqyrtimi.

#### **Për pasurinë shtëpi banimi e përbërë nga dy dhoma, një kuzhinë, me sipërfaqe 99,9 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, {\*\*\*}, Selitë, Tiranë**

11.1. Komisioni arriti në përfundimin se: [...] *Gjendja negative financiare e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj për krijimin e pasurisë shtëpi banimi me sipërfaqe 99,9 m<sup>2</sup> paraqitet në këtë mënyrë: pamundësi financiare në fund të vitit 2005 në vlerën (-) 1.037.583 (një milion e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre) lekë e krijuar për shkak të mosprovimit me dokumentacion të burimit të shitjes së sipërfaqes së padokumentuar të shtëpisë në Gramsh dhe gjendja negative në vitin 2011 prej (-) 11.503 (njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tre) lekësh. Në lidhje me këtë pasuri Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë të parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “a”, pasi nuk u arrit të provohet në sajë të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe atij të siguruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ ekzistenca e vlerës 1.100.000 (një milion e njëqind mijë) lekë si burim i të ardhurave nga shitja pa dokumentacion e një pjesë toke, magazinat, sipërfaqe ndihmëse dhe një garazh si pjesë e shtëpisë në Gramsh. Ajo ndodhet gjithashtu në pamundësi financiare me burime të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, në shumën (-) 1.037.583 (një milion e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre) lekë.*

*Kjo situatë negative financiare do të vlerësohet nga ana e Komisionit në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në zbatim të parimeve të proporcionalitetit dhe objektivitetit.*

**11.2.** Lidhur me këtë pasuri, Komisionerja Publike vlerëson se burimi i deklaruar i të ardhurave prej 1.100.000 lekësh i deklaruar vetëm në deklaratën *vetting*, si burim krijimi për pasurinë shtëpi banimi e përbërë nga dy dhoma, një kuzhinë, me sipërfaqe 99,9 m<sup>2</sup>, ndodhur në {\*\*\*}, Selitë, Tiranë, mbeti në nivel deklarativ dhe i paprovuar me dokument shoqërues, për rrjedhojë këto të ardhura, sipas Komisioneres Publike, nuk e kalojnë testin e provueshmërisë e, për pasojë, edhe testin e ligjshmërisë së tyre.

**11.3.** Trupi gjykues konstaton se Komisionerja Publike ndan të njëjtin qëndrim si Komisioni se nuk ka rrethana që mund të dokumentojnë ekzistencën e shitjes së 200 m<sup>2</sup> truall, së bashku me sipërfaqe ndërtimore të paregjistruara dhe përfitim të vlerës 1.100.000 lekë, në vitin 2005. Vetëm deklarimi i depozitës, me vlerë 2.300.000 lekë, në DPV-në 2004, me burim shitjen e shtëpisë, është i pamjaftueshëm në kuptim të vlerës së provës për të argumentuar ekzistencën e këtyre sipërfaqeve dhe vlerën e pretenduar prej 1.100.000 lekësh për shitjen e tyre dhe vlerëson se pretendimet e subjektit nuk u provuan me dokumentacion edhe pas riçeljes së hetimit administrativ.

**11.3/a.** Subjekti i rivlerësimit në prapësimet<sup>8</sup> e paraqitura në Komision ka kundërshtuar analizën e kryer nga Komisioni duke pretenduar, ndër të tjera, rishikimin e llogaritjeve të kryera nga ana e Komisionit mbi likuiditetet gjendje në llogaritë bankare të saj dhe të bashkëshortit, rishikimin e shpenzimeve të jetesës për periudhën që nga viti 1992 në përputhje me standardin e vendosur nga Kolegji, si dhe ka kërkuar të përfshihet në analizën financiare gjithë vlera e shitjes së shtëpisë në Gramsh në vitin 2005, përfshirë edhe pjesën informale në vlerën totale prej 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekësh, duke argumentuar se shuma prej 1.100.000 lekësh është e ardhur nga shitja e pasurisë truall + ndërtesë (garazh) në vitin 2005, e duke deklaruar, ndër të tjera, se këto veprime ndërmjet shtetasit G. B. blerësit të pasurisë dhe shtetasit M. L. bashkëshortit, janë kryer në rrugë bankare.

**11.4.** Trupi gjykues, me qëllim analizimin e plotë të këtij shkaku ankimi, pasi u njoh me pretendimet e Komisioneres Publike, si dhe shpjegimet e prapësimet e subjektit të rivlerësimit të dhëna në Komision dhe në Kolegji, mori në shqyrtim dokumentacionin e ndodhur në fashikujt e Komisionit ku rezultoi se:

**11.4/a.** Për këtë pasuri në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtëpi banimi e përbërë nga dy dhoma, një kuzhinë, me sipërfaqe 99,9 m<sup>2</sup>, blerë me kontratë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, pallati “{\*\*\*}”, {\*\*\*}, ap. {\*\*\*}, {\*\*\*}, Selitë, Tiranë<sup>9</sup>. Vlera e deklaruar e pasurisë është 61.480 euro.

Burimet e krijimit: *Kjo pasuri është krijuar nga: (1) kursimet e të ardhurave familjare; (2) shitja e një shtëpie që kemi pasur në Gramsh, përfutur me statusin e ushtarakut, paguar 79.712 lekë dhe shitur në vlerën 500.000 lekë; po ashtu edhe (3) shitja e një magazine, sipërfaqe ndihmëse, pjesë toke pa dokumentacion, në vlerën totale 1.100.000 lekë; si dhe (4) të ardhura familjare nga kursimet, si dhe interesa bankare nga viti 1997.*

<sup>8</sup> Prapësime të subjektit protokolluar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 12.12.2023.

<sup>9</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *vetting*, ndër të tjera: (1) kontratën e shitjes të kësaj pasurie të paluajtshme me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 22.12.2011, me palë blerëse M. L. dhe palë shitëse shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, në të cilën parashikohet se pala shitëse ka rënë dakord që të shesë këtë pronë palës blerëse, kundrejt shumës totale prej 61.480 eurosh, pagesa e së cilës është bërë jashtë kësaj zyre noteriale; si dhe (2) certifikatë për vërtetimin pronësie, datë 17.01.2012, për këtë pasuri

**11.4/b.** Në deklaratën periodike të vitit 2008, subjekti ka deklaruar: *Prenotim apartamenti 2+1, në Tiranë, me sipërfaqe 116 m<sup>2</sup> nga shoqëria me administrator I. B.. Shlyer 55.000 euro dhe detyrimi i mbetur është deklaruar në vlerën 8.000 euro.*

**11.4/c.** Në deklaratën periodike të vitit 2011, subjekti ka deklaruar: *Lidhur kontrata e shitjes për apartamentin 2+1, me sip. 99,9 m<sup>2</sup>, në Selitë, Tiranë, në datën 22.12.2011, me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., pasuri e regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, me nr. {\*\*\*}, më 17.01.2012.* Subjekti ka deklaruar se me përcaktimin e sipërfaqes së bërë me hartimin e kontratës është përcaktuar vlera totale e apartamentit 61.480 euro, shuma 55.000 euro, paguar në vitin 2008 dhe e deklaruar nga subjekti në vitin 2008, ndërsa diferenca 6.480 euro është paguar në 2011, me lidhjen e kontratës së shitjes.

**11.4/d.** Në përgjigje të pyetësorit nr.1, subjekti, ndër të tjera, mbi mënyrën e shlyerjes së vlerës së kësaj pasurie, ka deklaruar se: *[...] Pagesa për këtë apartament, shtëpi banimi është bërë nga viti 2008 deri në vitin 2011. Burimi financiar për këtë blerje është nga të ardhurat nga pagat, depozitat bankare, si dhe shitja e një shtëpie dhe objekteve të tjera të lidhura me të, në qytetin Gramsh. Mënyra e pagimit për këtë pasuri është bërë me dy këste në vitin 2008: më datë 29.05.2008 - 30.000 euro dhe më datë 07.08.2008 - 25.000 euro, të marra nga depozitat bankare që kemi pasur. Pjesa e mbetur në vlerën 6.480 euro është likuiduar në vitin 2009 [...].*

**11.5.** Në analizë të burimeve të deklaruara në deklaratën *vetting*, për pasurinë apartament 2+1, me sip. 99,9 m<sup>2</sup>, ndodhur në Selitë, Tiranë, trupi gjykues konstaton se një ndër burimet e deklaruara është ajo në vlerën 500.000 lekë, nga shitja e një shtëpie në Gramsh dhe nga aktet e fashikullit të dosjes së Komisionit për këtë burim rezulton se:

**11.5/a.** Drejtoria Vendore e ASHK-së Gramsh ka përcjellë në Komision dosjen e pasurisë, nga e cila konstatohet se pasuria e llojit “apartament”, me sipërfaqe totale 247 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtese 92,71 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Zonën Kadastrale nr. {\*\*\*}, ka qenë pronë e Entit Kombëtar të Banesave dhe në vitin 2002 kjo pronë është përfitur nga M. L., R. L. dhe Zena Lila, për vlerën 79.712 lekë. Sipas dokumentacionit rezulton se subjekti i rivlerësimit, bashkëshorti dhe shtetasja R. L. (motra e bashkëshortit), pasurinë e llojit apartament, me sipërfaqe 247 m<sup>2</sup>, nga kjo truall 247 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 92,71 m<sup>2</sup>, ia kanë shitur, me kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 01.02.2005, shtetasit G. B., për vlerën 500.000 lekë.

**11.5/b.** Në deklaratën periodike të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartment 2+1, të ndodhur në qytetin e Gramshit, me sipërfaqe ndërtese 92,7 m<sup>2</sup> dhe totale 247 m<sup>2</sup>. Privatizimi i banesave ushtarake nga EKB (përfitur me status ushtaraku falas).* Në deklarimin periodik të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar: *Depozitë bankare në Bankën e Kursimeve, Gramsh, vlera 2.300.000 lekë, datë 01.02.2005, shitur shtëpia.*

Nga verifikimi i deklaratave periodike, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar shitjen e kësaj pasurie, si detyrim ligjor i parashikuar në shkronjën “a”, në nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003<sup>10</sup>, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

---

<sup>10</sup> Në nenin 4, shkronja “a” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, parashikohet: “4. Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe



**11.6. Lidhur me burimin e deklaruar në deklaratën vetting, shitja e një magazine, sipërfaqe ndihmëse, pjesë toke pa dokumentacion në vlerën totale 1.100.000 lekë,** trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit e deklaroi këtë burim për herë të parë në deklaratën vetting dhe nga aktet nuk rezultoi të ketë paraqitur ndonjë dokumentacion justifikues ligjor mbi posedimin e kësaj pasurie dhe të ardhurat e pretenduara të përfituara.

**11.6/a.** Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar: [...] *Shtëpi banimi Gramsh, [...] përfituar me statusin e ushtarakut nga M. L.. Pas përfitimit të kësaj shtëpie në të është investuar duke u ndërtuar garazh, magazinë dhe sipërfaqe ndihmëse, ku këto shtesa nuk janë regjistruar në ZVRPP. Në vitin 2005 është bërë shitja e banesës së bashku me garazhin, magazinë dhe sipërfaqe ndihmëse, ku shitja është dokumentuar me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 01.02.2005 [...].*

**11.6/b.** Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie, Komisioni, pasi nuk e përfshiu në analizë vlerën prej 1.100.000 lekësh, duke e konsideruar deklarative dhe të pambështetur në dokumentacion provues, i kaloi subjektit barrën e provës, duke arritur në konkluzionin se:

- *Subjekti i rivlerësimit ka kryer pagesën për këtë pasuri në vitin 2008, në shumën 55.000 euro, por ajo rezultoi në pamundësi financiare ndër vite për krijimin e kësaj shume, po ashtu edhe për pagesën e kryer në vitin 2011.*

- *Nga hetimi i llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të (bashkëshortit) rezultoi se bashkëshorti derdh në bankë shuma parash cash, për të cilat deri në këtë moment mbetet i paprovuar burimi i ligjshëm i tyre.*

- *Subjekti i rivlerësimit rezultoi në pamundësi financiare në shumën (-) 2.330.23110 lekë, për krijimin e shumës 55.000, përdorur për kryerjen e pagesës në vitin 2008 dhe (-) 274.633 lekë, për kryerjen e pagesës në vitin 2011, në total (-) 2.604.864 lekë, për krijimin e pasurisë apartament banimi, me sipërfaqe 99,9 m<sup>2</sup>, ndodhur në Selitë, Tiranë, në vlerën 61.480 euro.*

**11.6/c.** Lidhur me konsiderimin e shumës prej 1.100.000 lekësh, në prapësimet e paraqitura në Komision, subjekti, ndër të tjera, deklaroi se: *“Së dyti, vlerësoj se 1.100.000 (një milion e njëqind mijë) lekë nuk është në nivel deklarativ. Shuma e shënuar në kontratën e shitblerjes për pjesën e pasurisë së regjistruar në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë dhe shuma e paguar për pjesën e paregjistruar të pronës, në vlerën 1.100.000 (një milion e njëqind mijë) lekë, janë paguar në të njëjtën datë nga blerësi G. B.. Shuma në total prej 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekësh është depozituar nga G. B. në llogari te M. L., në Raiffeisen Bank. Shumës prej 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekësh i është shtuar dhe 100.000 (njëqind mijë) lekë nga M. L., nga kursime të vitit, dhe kjo shumë është vendosur në të njëjtën datë në depozitë me afat 6-mujor nga M. L., në Raiffeisen Bank. Pra, depozita në vlerën 1.700.000 (një milion e shtatëqind mijë) lekë ka si burim çmimin e shitjes së banesës, paguar nga G. B., në vlerën 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë dhe shumën 100.000 (njëqind mijë) lekë, shtuar nga M. L., nga kursimet familjare të atij viti. Këtë fakt e provon më së miri depozita me afat në Raiffeisen Bank e çelur në datën e shitjes së banesës në qytetin e*

---

*Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil [...].”*

*Gramshit me kontratë shitblerjeje. Këto veprime ndërmjet shtetasve G. B. dhe M. L. janë kryer në rrugë bankare. Deklarimi i kësaj shume nuk është deklaruar vetëm në deklaratën vetting, pasi shitja e shtëpisë është deklaruar në deklaratën e vitit 2004, e cila dorëzohet në fund të muajit mars të vitit 2005 [...]. Kjo shumë duhet të përfshihet në analizë financiare, pasi është provuar që vjen nga një burim i ligjshëm.*

**11.6/d.** Subjekti i rivlerësimit, fillimisht në prapësime pretendoi se veprimet ndërmjet bashkëshortit të saj dhe blerësit, G. B. për shumën prej 1.600.000 lekësh, të përfituar nga shitja e shtëpisë në Gramsh, janë kryer në rrugë bankare, ndërsa në seancën dëgjimore të zhvilluar në Komision, përfaqësuesi i subjektit të rivlerësimit pretendoi se shuma prej 1.400.000 lekësh ka qenë gjendje në llogarinë e shtetasit G. B., ku është tërhequr *cash* dhe i është paguar *cash* shtetasit M. L., së bashku me 200.000 (dyqind mijë) lekë që i kishte jashtë sistemit bankar. Pretendimit për ekzistencën e kësaj gjendjeje lekësh në llogarinë e shtetasit G. B., përfaqësuesi i subjektit të rivlerësimit i bashkëlidhi korrespondencën me punonjësin e Raiffeisen Bank, sipas së cilës vetë subjekti nuk mund të kërkonte informacion për shtetasin G. B. duke qenë se përbënte *sekret bankar*. Nga ana tjetër, Komisioni kishte të drejtë ta siguronte këtë informacion të legjitimuar nga ligji nr. 84/2016.

**11.6/dh.** Komisioni, pas kërkesës së përfaqësuesit ligjor gjatë seancës dëgjimore publike të datës 13.12.2023, për të kërkuar marrjen e provave shtesë, në datën 14.12.2023, vendosi në dhomë këshillimi të riçelë hetimin administrativ për të siguruar informacionin e nevojshëm nga Raiffeisen Bank, në lidhje me gjendjen e llogarisë së shtetasit G. B., në momentin e shitblerjes së pasurisë në Gramsh, si dhe pranë Bankës së Shqipërisë dhe bankës së nivelit të dytë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm në funksion të një vendimmarrjeje të drejtë, si dhe konsideruar faktin që këto prova nuk u paraqitën nga vetë subjekti i rivlerësimit.

**11.6/e.** Nga dokumentacioni i administruar pas riçeljes së hetimit administrativ, në lidhje me gjendjen e llogarisë bankare të shtetasit G. B., rezultoi se në llogarinë e tij në Bankën e Kursimeve (tani RBAL), dega Gramsh, figuroi vetëm një depozitë prej 4.200 eurosh, e cila është tërhequr nga llogaria në datën 15.12.2004. Nuk u konstatua tërheqje e shumës 1.400.000 lekë apo e një vlere të përafërt nga ana e këtij shtetasi apo e familjarëve të tij, në datën 01.02.2005, në momentin e shitblerjes së shtëpisë në Gramsh.

**11.7.** Në përfundim, Komisioni arriti në konkluzionin se nuk ka rrethana që mund të dokumentojnë ekzistencën e shitjes së 200 m<sup>2</sup> truall, së bashku me sipërfaqe ndërtimore të paregjistruara dhe përfitimin e vlerës 1.100.000 lekë, në vitin 2005. Vetëm deklarimin e depozitës, me vlerë 2.300.000 lekë, në deklaratën periodike të vitit 2004, me burim shitjen e shtëpisë, Komisioni e konsideroi të pamjaftueshëm në kuptim të vlerës së provës për të argumentuar ekzistencën e këtyre sipërfaqeve dhe vlerën e pretenduar prej 1.100.000 lekësh për shitjen e tyre, ndaj nuk e konsideroi në analizën e rishikuar financiare.

**11.8.** Subjekti i rivlerësimit së bashku me prapësimet e paraqitura në Komisioni ka dorëzuar deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 27.01.2022, në të cilën shtetasi G. B. (trashëgimtari ligjor i shtetasit G. B., të cilit subjekti dhe personat e lidhur i kanë shitur shtëpinë), ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] *Në vitin 2005, babai im ka blerë nga familja e M. L. një truall me sipërfaqe 247 m<sup>2</sup> dhe ndërtesa prej 92,71 m<sup>2</sup>, që dokumentohej me dokument pronësie. Krahas këtij trualli dhe ndërtesë është blerë dhe një sipërfaqe trualli prej 200 m<sup>2</sup>, si*

*dhe pjesë godine si garazh, magazinë e rrethuar me mur rrethues, si dhe materiale ndërtimi që gjendeshin në objekt etj., por që për këto të fundit M. L. nuk dispononte dokument pronësie dhe fakti i blerjes nuk është pasqyruar në kontratën e shitjes të lidhur ndërmjet familjes së M. L. dhe babit tim [...]. Trualli i regjistruar dhe i paregjistruar së bashku me ndërtesën dhe shtesat e bëra i janë shitur babait tim, G. B., në vlerë totale 1.600.000 lekë [...]. Nga vlera totale prej 1.600.000 lekësh, babai im shumë prej 1.400.000 lekësh e ka kaluar nëpërmjet bankës, ndërsa shumë prej 200.000 lekësh e ka paguar cash. Kjo provohet dhe nga veprimet bankare [...].*

**11.9.** Lidhur me deklaratën noteriale<sup>11</sup> të sipërcituar, ashtu si edhe Komisionerja Publike, trupi gjykues vlerëson se duhet të merret me rezervë, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit, është në favor të deklarimeve të subjektit, por nuk rezulton të jetë në harmoni me provat e administruara në procesin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit mbeti e paprovuar si ekzistenca e pasurisë 200 m<sup>2</sup> truall, së bashku me sipërfaqe ndërtimore të paregjistruar, ashtu dhe të ardhurat e pretenduara të përfituara prej saj, në vlerën prej 1.100.000 lekësh.

**11.10.** Nga sa më lart analizuar, trupi gjykues vëren se, ndonëse shkak i ngritur në ankim nga Komisionerja Publike, lidhur me mospërfshirjen në analizën financiare të subjektit të vlerës 1.100.000 lekë në vitin 2005, përputhet me qëndrimin e Komisionit, ndryshimi në këtë rast qëndron në faktin se sipas Komisioneres Publike e gjithë vlera, për burimin e deklaruar prej 1.100.000 lekësh për krijimin e likuiditeteve në vitin 2005, e përdorur në vitin 2008 për pagesën e kësteve të apartamentit, përbën pamjaftueshmëri financiare, kurse Komisioni e ka lidhur pamundësinë financiare të subjektit për krijimin e apartamentit në Tiranë me rezultatin e analizës financiare të vitit 2005, nga ku subjekti i rivlerësimit rezulton me një mungesë prej (-) 1.037.583 lekësh në këtë vit.

**11.11.** Gjithashtu, trupi gjykues vëren se Komisioni e ka vlerësuar mungesën e burimeve financiare të ligjshme në frymën e parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, duke mos e penalizuar subjektin me masën disiplinore të shkarkimit, ndërsa Komisionerja Publike ka vlerësuar se pamjaftueshmëria financiare e konstatuar, por edhe pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme në krijimin e depozitave të investuara në formën e bonove të thesarit dhe mbulimin e shpenzimeve të periudhës së analizuar, e ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, duke e bërë deklarin e saj, për kriterin e kontrollit të pasurisë, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

**11.12.** Trupi gjykues, në analizë të akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, ato të përcjella nga ILDKPKI-ja, si dhe të deklarimeve e shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me mospërfshirjen në analizën financiare të shumë prej 1.100.000 lekësh të përfitur nga shitja e objektit të paregjistruar në Gramsh, konstaton se subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor asnjë gjurmë të sipërfaqes informale të pretenduar në posedim. Kontrata e shitjes, datë 01.02.2005, referon vetëm sipërfaqen e dokumentuar të pronës, po ashtu edhe vlera e shitjes e përcaktuar si në kontratën e shitjes edhe në ZVRPP, është 500.000 (pesëqind mijë) lekë, aq sa është përlllogaritur në analizën financiare të

<sup>11</sup> Së bashku me prapësimet, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dhe deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 27.01.2022, në të cilën shtetasi G. B. (trashëgimtari ligjor i shtetasit G. B., të cilit subjekti dhe personat e lidhur i kanë shitur shtëpinë).

Komisionit. Në deklaratën periodike të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar zotërimin e pasurisë së paluajtshme në Gramsh, por vetëm sipërfaqja e dokumentuar e pronës truall dhe ndërtesë, ish-objekt ushtarak, përfituar me privatizim nga EKB-ja, ndërsa në deklaratat periodike vjetore të viteve 2003, 2004 apo 2005 nuk përmendet ekzistenca e sipërfaqes informale të pronës. Për rrjedhojë nga sa konstatuar më lart, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e pretenduara të përfituara nga shitja e kësaj prone me të drejtë nuk janë përfshirë në analizën financiare.

**11.13.** Në përfundim, për pasurinë shtëpi banimi, me sipërfaqe 99,9 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, {\*\*\*}, Selitë, Tiranë, trupi gjykues, duke marrë në konsideratë konkluzionin e Komisionit dhe vlerësimin e Komisioneres Publike në ankim, vlerëson se burimi i krijimit të të ardhurave prej 1.100.000 lekësh, i deklaruar vetëm në deklaratën *vetting*, si një nga burimet e krijimit për këtë pasuri, mbeti në nivel deklarativ dhe i paprovuar me dokumentacion justifikues ligjor dhe akte të kohës, për rrjedhojë nuk e kalon testin e provueshmërisë si burim i ligjshëm e, për pasojë, edhe testin e ligjshmërisë së të ardhurave, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

## **12. Depozitë bankare në Bankën e Shqipërisë – Bono Thesari, në vlerën 3.860.000 (tre milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë**

**12.1.** Komisioni, pasi mori në vlerësim pretendimet e subjektit të rivlerësimit, që si burim i krijimit të depozitave bankare, që janë investuar në Bono Thesari në vitet 2010 – 2011, kanë shërbyer deklaratimet e gjendjeve *cash* të kursyera në banesë, duke filluar nga viti 2007 deri në vitin 2009, si dhe shuma e deklaruar *cash* pas vitit 2012 deri në vitin 2016 të jetë gjendje e krijuar gjatë atij viti, arriti në konkluzionin se, për krijimin e pasurisë Bono Thesari në vlerën 3.860.000 (tre milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë me burim të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, të akumuluar në banesë nga kursimet nga pagat dhe interesat bankarë, subjekti i rivlerësimit rezulton në kushtet e pamjaftueshmërisë me burime financiare për të justifikuar krijimin e saj, sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, në vitin 2011 në vlerën (-) 11.503 (njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tre) lekë dhe në vitet 2012 – 2016 në vlerën (-) 218.307 (dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e treqind e shtatë) lekë; **në total në vlerën (-) 229.810 (dyqind e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e dhjetë) lekë.**

Komisioni, këtë situatë në drejtim të ligjshmërisë së burimeve të përdorura nga subjekti për këtë pasuri, si dhe pasaktësinë në deklarimin e gjendjes *cash*, çmoi që ta konsiderojë në vlerësim tërësor të të gjithë kontrollit të kriterit të pasurisë në të gjitha elementet e tij.

**12.2.** Komisionerja Publike, në ankimin e paraqitur në Kolegj, nuk ndan qëndrim dhe vlerësim të njëjtë me Komisionin, pasi **pamjaftueshmëria financiare për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të**, për vitet e analizuara, do të rezultonte e ndryshme nga pamjaftueshmëria e konstatuar nga Komisioni në funksion edhe të rivlerësimit të zërave: **(i) shpenzime jetese për vitin 2007; dhe (ii) kursime në *cash* ndër vite.**

### **i. Shpenzimet e jetesës për vitin 2007**

**12.3.** Komisionerja Publike, pasi ka rishikuar analizën e vitit 2007 dhe ka llogaritur zërin e shpenzimeve të jetesës në përputhje me standardin e përdorur në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, bazuar në korrespondencën me ILDKPKI-në, i ka rritur shpenzimet e jetesës me

vlerën 397.392 lekë dhe, po me të njëjtën vlerë, është rritur edhe pamjaftueshmëria financiare e konstatuar nga Komisioni<sup>12</sup>, duke arritur një vlerë negative që sipas Komisioneres Publike nuk mund t'i nënshtrohet parimit të proporcionalitetit të parashikuar nga neni 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

**12.3/a.** Trupi gjykues, pasi kontrolloi analizën financiare të kryer në Komision, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, konstaton se Komisioni në analizën e vitit 2007 ka konsideruar shpenzimet e jetesës për familjen me 4 persona në vlerën prej 546.480 lekësh. Në tabelën e analizës financiare, Komisioni ka vendosur me shënim se referuar shkresës së ILDKPKI-së nr. {\*\*\*}, datë 29.01.2019, shpenzimet për frymë për vitin 2007 janë 235.968 lekë, vlerë e cila është dyfish krahasuar me vitet 2006 dhe 2008, për këtë arsye, Komisioni, referuar praktikës së tij, konsideroi vlerën e shpenzimeve për frymë sipas të dhënave të vitit pasardhës 2008, pasi kjo rritje dhe ulje nuk bazohet në shifrat e inflacionit zyrtar, i cili në vitin 2006 është 2.5%, në vitin 2007 është 3% dhe në vitin 2008 është 2%.

**12.3/b.** Në shqyrtim të këtij shkakui ankimi, trupit gjykues i rezultoi se shpenzimet e jetesës për vitin 2007, Komisionerja Publike i ka përlllogaritur bazuar në të dhënat e përcjella nga ILDKPKI-ja<sup>13</sup> në institucionet e rivlerësimit. Këto të dhëna të pasqyruara në tabelën përmbledhëse të shpenzimeve të jetesës të hartuar nga ILDKPKI-ja janë bazuar në standardet e raportuara nga institucioni i vetëm i specializuar për statistikat, INSTAT, dhe këto vlera janë përdorur nga ILDKPKI-ja nga viti 2004 e në vijim, në ushtrimin e funksioneve të saj kontrolluese ndaj subjekteve deklaruese, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*, i ndryshuar.

**12.3/c.** Sa më sipër, për sa ka paraqitur në ankim Komisionerja Publike, referuar analizës së vitit 2007, trupi gjykues vlerëson të drejtë pretendimin e tij për konsiderimin e shpenzimeve për këtë vit në vlerën prej 943.872 lekësh të përlllogaritura sipas shkresës së ILDKPKI-së me burim INSTAT-in, si dhe referuar jurisprudencës së Kolegjit. Mënyra e vlerësimit të këtij zëri shpenzimesh, sipas standardit të ILDKPKI-së, bazuar në të dhënat e INSTAT-it për secilin vit të analizës financiare, përfshirë dhe vitin 2007, përbën një qëndrim të konsoliduar tashmë nga jurisprudenca e Kolegjit<sup>14</sup>, mbështetur në të dhëna të standardizuara, dokumente dhe prova të besueshme, sipas parashikimit të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, por edhe në mbështetje të dispozitave të ligjit të sipërcituar se procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve kryhet nga organet e rivlerësimit me ndihmën e organeve të tjera shtetërore të specializuara, bazuar në parimin e bashkëpunimit, të ndërveprimit dhe të kontrollit mes të gjitha organeve të përfshira në të.

**12.3/d.** Si rezultat i rishikimit të analizës financiare në Kolegji, në përputhje me standardin e sipërcituar, duke aplikuar shpenzimet e jetesës në vlerën prej 943.872 lekësh, pra, në vlerën prej 397.392 lekësh më shumë se Komisioni, në të njëjtën vlerë do të rritej dhe pamjaftueshmëria financiare e konstatuar nga Komisioni, pra, diferenca negative prej (-)

---

<sup>12</sup> Diferenca në këtë rast do të shkonte në shumën (-) 2.081.201 lekë.

<sup>13</sup> Shkresë e përcjellë nga ILDKPKI-ja në Kolegji, nr. {\*\*\*} prot., datë 04.03.2019.

<sup>14</sup> Vendimet e Kolegjit (JR) nr. 18, datë 08.06.2022, (JR) nr. 32, datë 24.07.2023 dhe (JR) nr. 53, datë 15.12.2023.

**1.683.808 lekësh** totale që i ka rezultuar Komisionit për vitet 2005, 2007, 2011 dhe 2012 do të shkonte në shumën (-) **2.081.201 lekë**.

## ii. Kursime në *cash* ndër vite

12.4. Komisioni, pasi ka përgatitur raportin e rezultateve hetimore, i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi ky i fundit në analizën financiare ka rezultuar me një total diference negative prej (-) **4.368.990 lekësh**.

Komisioni në vendim, pasi administroi shpjegimet e dhëna nga subjekti, lidhur me analizën finale: (a) duke konsideruar saktësim të balancave në llogaritë bankare në vitet 2004-2007 e 2013-2016; (b) duke ndryshuar likuiditetet *cash* në vitet 2010-2016; (c) duke saktësuar të ardhurat nga interesat bankare në vitet 2010-2015 (shtuar në vitet 2010-2014 e pakësuar në vitin 2015), ka kryer ulje të balancës negative<sup>15</sup>, në total prej (-) **1.683.809 lekësh** (diferenca negative në vitet 2005 prej (-) 1.037.583 lekësh, në vitin 2007 prej (-) 416.416 lekësh, në vitin 2011 prej (-) 11.503 lekësh dhe në vitin 2012 prej (-) 218.307 lekësh).

Në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, Komisioni ka vlerësuar se: [...] nga analiza e përgjithshme financiare rezulton se, për periudhën 2003 – 2016, subjekti i rivlerësimit është me vlerë negative prej (-) 1.683.809 lekësh<sup>16</sup>. Trupi gjykues çmon se situata faktike e gjendjes *cash*, gjatë viteve 2010 – 2016, dukshëm nuk është deklaruar saktë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratimet periodike vjetore, përderisa nuk krijon vijueshmëri logjike dhe as harmoni me deklarin e gjendjes *cash* në deklaratën vetting. Po ashtu, nuk rezultojnë pasuri të tjera të krijuara apo shpenzime të mundshme të kryera nga familja e subjektit të rivlerësimit, të cilat mund të krijonin dyshime të arsyeshme se deklarin e pasakta mund të ishin të qëllimshme.

Rezultati negativ financiar mbi gjendjen e pamjaftueshmërisë financiare të subjektit, të krijuar për vitet 2010 – 2016, është i ulët në krahasim me vlerën 3.100.000 lekë, të krijuar nga akumulimi i gjendjes *cash*, ndaj në vlerësim të trupit gjykues, kjo gjendje mund të mos reflektojë situatën faktike të subjektit. Leximi më koherent dhe logjik i gjendjes *cash*, të deklaruar për vitet 2010 – 2016, është që gjendja *cash* të jetë gjendje e krijuar gjatë vitit të deklarimit deri në deklaratën vetting. Në analizë të përgjithshme, pasuria e subjektit të rivlerësimit përgjatë periudhës së rivlerësimit përbëhet nga një shtëpi e ndodhur në Selitë, një automjet tip “Ford Fusion” dhe një pasuri Bono Thesari, në vlerën 3.860.000 lekë, e krijuar me kursimet e punës së pandërprerë prej vitit 1992, për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin e saj.

Rezultati negativ financiar gjatë vitit 2005, për shkak të mosprovimit të shumës 1.100.000 lekë, si e përfituar nga shitja e shtesave të shtëpisë në Gramsh, rezultati negativ në vitin 2007 dhe rezultati negativ gjatë viteve 2010 – 2016, që dukshëm ka ardhur për shkak të pasaktësive në deklarime të bëra ndër vite të kursimeve *cash*, në frymë të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk përbën shkak të qëllimshëm të penalizimit me masën disiplinore të shkarkimit sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në tërësi vlerësohet se subjekti ka arritur

<sup>15</sup> Sipas tabelës së analizës financiare në faqe 18 të vendimit të Komisionit.

<sup>16</sup> Përkatësisht: (-) 1.453.999 lekë, në vitet 2005 – 2007, për krijimin e likuiditeteve bankare dhe gjendjes *cash* në vitin 2007; në vlerën (-) 11.503 lekë, në vitin 2011, për pagimin e kështit të fundit të pasurisë shtëpi banimi, me sip. 99,9 m<sup>2</sup>, por edhe të shtimit të pasurisë Bono Thesari, si dhe në vlerën (-) 218.307, në vitin 2012, për shtimin e pasurisë Bono Thesari.

*një nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë sipas nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 [...].*

**12.5.** Komisionerja Publike në ankimin e paraqitur pretendon për një diferencë negative në vitin 2005 prej (-) 1.100.000 lekësh për krijimin e likuiditeteve të cilat janë përdorur në vitin 2008 e kanë shërbyer për pagesën e këstit të parë të apartamentit, si dhe diferencë negative për vitet 2007-2016 prej (-) 1.650.803 lekësh, pra, në total, sipas Komisioneres Publike, subjekti do të ndodhej me një diferencë negative prej (-) **2.750.803 lekësh.**

**12.5/a.** Në lidhje me trajtimin e kursimeve *cash* dhe mbulimin e shpenzimeve dhe kursimeve me burime të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe pasaktësitë në deklarimin e kursimeve *cash* nga ana e subjektit (fokusuar në vitet 2010-2016), Komisionerja Publike ka vlerësuar në ankim se arsyetimi i Komisionit nuk përputhet me gjendjen që janë aktet në dosje, si dhe bie ndesh me jurisprudencën orientuese dhe tashmë të konsoliduar të Kolegjit<sup>17</sup>, e cila ka vlerësuar deklarimin e subjekteve të rivlerësimit në deklaratimet periodike të interesave, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

**12.5/b.** Në vlerësimin e Komisioneres Publike, analiza financiare e subjektit të rivlerësimit duhet kryer duke llogaritur për çdo vit kursimet në *cash* si shtesa të kursimeve dhe pa pakësuar kursimet e akumuluar në vitet e mëparshme, në përputhje me deklaratimet në deklaratat periodike vjetore. Si rezultat i kryerjes së analizës financiare, bazuar në argumentet e mësipërme, Komisioneres Publike i rezulton se përveç pamjaftueshmërisë financiare, konstatuar për krijimin e likuiditeteve në vitin 2005, në shumën (-) 1.100.000 lekë (likuiditete të cilat duket se janë tërhequr në vitin 2008 dhe kanë shërbyer për pagesën e këstit të parë të apartamentit), do të rezultonte dhe pamjaftueshmëri financiare për periudhën 2007-2016, në vlerën (-) 1.650.803 lekë<sup>18</sup>.

**12.6.** Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues mori në shqyrtim dokumentacionin e ndodhur në fashikujt e Komisionit ku konstatoi se:

Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Depozitë bankare në Bankën e Shqipërisë – Bono Thesari në vlerën 3.860.000 lekë, me burim kursimet nga paga e saj si prokurore dhe ajo e bashkëshortit si mjek.*

Në deklaratën periodike të vitit 2010, subjekti ka deklaruar: *Depozitë bankare në Bankën e Shqipërisë, 1.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.*

Në deklaratën periodike të vitit 2012, subjekti ka deklaruar: *Depozitë Bono Thesari në Bankën e Shqipërisë çelur në qershor të vitit 2010 shtuar me 500.000 (pesëqind mijë) lekë. Pjesa takuese: 50%.*

---

<sup>17</sup> Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 11/2019 (JR); nr. 19/2019 (JR); nr. 20/2019 (JR) dhe nr. 27/2020 (JR).

<sup>18</sup> Diferencë që përbëhet prej: (-) 635.303 lekë, për vitin 2007, duke konsideruar shpenzime jetese sipas standardit të përdorur nga KPA, shtesë kursimesh *cash*, në shumën 500.000 lekë dhe shtesës së likuiditeteve në llogaritë bankare; (-) 76.717 lekë, për vitin 2008, duke konsideruar shtesë kursime në *cash* në vlerën 600.000 lekë; (-) 386.108 lekë, për vitin 2010, si rezultat i shtesës së gjendjes *cash* të vitit 2010, në shumën e deklaruar +400.000 lekë; (-) 112.503 lekë, në vitin 2011, si rezultat i pakësimit të kursimeve *cash* të vitit 2011, në shumën e deklaruar (-) 1.300.000 lekë; (-) 220.308 lekë, për vitin 2012, si rezultat i shtesës së gjendjes *cash* të vitit 2012, në shumën e deklaruar + 700.000 lekë; (-) 219.864 lekë, për vitin 2016, si rezultat i shtesës së gjendjes *cash* të vitit 2014, në shumën e deklaruar + 700.000 lekë.

**12.6/a.** Nga verifikimi i transaksioneve bankare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj ka rezultuar:

**i)** Në datën 17.06.2010, bashkëshorti i subjektit ka depozituar në *cash*, në International Comercial Bank (në vijim “ICB”, sot Union Bank), shumën 1.000.000 lekë, e cila do të investohej në blerje Bono Thesari, në Bankën e Shqipërisë nga z. M. L. (bashkëshorti i subjektit). Gjendja e likuiditeteve në Bankën e Shqipërisë në datën 31.12.2010 është në shumën 1.000.000 lekë, në emër të z. M. L..

**ii)** Është çelur Bono Thesari në Bankën e Shqipërisë në datën 01.02.2011, në shumën 1.000.000 lekë, në emër të z. M. L. dhe në datën 23.06.2011, nëpërmjet ICB-së është kryer transaksioni, duke depozituar *cash* shumën 500.000 lekë, nga llogaria e z. M. L. e investuar për blerje Bono Thesari.

**iii)** Depozitim *cash*, në datën 15.06.2012, nga z. M. L., në llogarinë e pagës në Credins Bank, në shumën 500.500 lekë dhe transferuar për t’u investuar në Bono Thesari në Bankën e Shqipërisë.

**iv)** Në datën 15.01.2013, është depozituar në Fibank, në llogarinë në emër të M. L., shuma 500.500 lekë dhe është transferuar për t’u investuar në Bono Thesari te Banka e Shqipërisë, në emër të M. L..

**v)** Gjendja e likuiditeteve të investuara në Bono Thesari në Bankën e Shqipërisë në datën 31.12.2013 është në shumën 3.500.000 lekë.

**12.6/b.** Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të Komisionit, subjekti ka shpjeguar se: *Në deklaratat periodike vjetore të periudhave 2007-2010, shumat e deklaruara si gjendje cash përfaqësojnë vetëm sasinë e lekëve cash të kursyera vetëm për vitin përkatës të deklarimit dhe jo mbledhje aritmetike me vitet e mëparshme, pra pasqyrohen vetëm shtesat për atë vit deklarimi [...].* Në të njëjtin pyetësor, subjekti ka deklaruar se vetëm në vitin 2011 ka pasur pakësim të kursimeve në *cash* në vlerën 1.300.000 lekë.

**12.6/c.** Komisioni ka kryer analizën financiare në momentin e depozitimeve të shumave si më sipër dhe në përfundim të rezultateve të hetimit administrativ i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi nga analiza ka rezultuar mungesë likuiditetesh për krijimin e tyre, konkretisht për depozitim të likuiditeteve në vitin 2010, mungesë fondesh në shumën (-) 636.063 lekë, shtesat në vitin 2011, në shumën (-) 1.027.326 lekë, si dhe shtesat e vitit 2013, në shumën (-) 402.431 lekë. Subjekti rivlerësimit ka rezultuar në pamundësi financiare në shumën (-) **2.065.820 lekë**, për investimin në Bono Thesari, në vlerën 3.860.000 lekë, të deklaruara në deklaratën *vetting*.

**12.6/ç.** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës në prapësimet e saj, ka shpjeguar se: *Për vitin 2010, më datë 17.6.2010, është bërë transfertë bankare nëpërmjet (ICB) sot Union Bank, në vlerën 1.000.000 (një milion) lekë dhe është bërë transfertë nëpërmjet kësaj banke tek Banka e Shqipërisë për blerje Bono Thesari, me afat maturimi 1-vjeçar. Si burim për krijimin e kësaj shume janë të ardhurat e kursyera nga familja Lila për vitet 2007, 2008, 2009, gjendje cash në banesë, deklaruar në deklaratimet periodike përkatëse. Ku referuar deklarimeve periodike në vitin 2007 gjendja cash ka qenë 500.000 lekë, në vitin 2008 gjendja cash 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë, ndërsa në vitin 2009 gjendja cash 900.000 (nëntëqind mijë) lekë, që*



do të thotë se në fillim të vitit 2010 familja e Zena Lilës kishte kursime cash në banesë në vlerën 2.000.000 (dy milionë) lekë. Ky fakt provon se M. L. në datën 17.06.2010 kishte të ardhura nga burime të ligjshme për të krijuar depozitën në vlerën 1.000.000 (një milion) lekë, për blerje Bono Thesari. Këto lekë janë mbajtur në banesë dhe janë deklaruar në deklaratimet periodike të viteve 2007, 2008 dhe 2009, ku për vitet përkatëse janë deklaruar vetëm gjendja cash, për secilin vit. Nuk janë vendosur depozitë si në vitet e mëparshme, pasi familja Lila i mbante disponibël për pagimin e këstit të mbetur prej 6.480 (gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë) euro, ku pagimi i këtij kësti diktohej nga momenti që shitësi do të përpilonte kontratën e shitblerjes. Në vitin 2011, në datën 01.02.2011, është bërë transfertë nëpërmjet bankës së nivelit të dytë në vlerën 1.000.000 (një milion) lekë dhe është bërë transfertë për Bono Thesari në Bankën e Shqipërisë, me afat maturimi 1-vjeçar, ku kjo vlerë si burim ka të ardhurat e familjes Lila për vitin 2010, si dhe gjendjet cash të viteve të mëparshme, si dhe interesat bankarë [...].

**12.6/d.** Pas riçeljes së hetimit administrativ, Komisioni rikërkoi pranë bankave të nivelit të dytë dhe Bankës së Shqipërisë informacion mbi vlerat e interesave bankarë të përfutur nga investimet në Bono Thesari. Banka e Shqipërisë ka përcjellë informacionin e plotë në lidhje me interesat e gjeneruara nga Bonot e Thesarit të viteve 2010 dhe 2011. Këto vlera janë përlllogaritur nga Komisioni në analizën e përgjithshme financiare të subjektit, si dhe në mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj për të krijuar pasurinë Bono Thesari dhe shtesat e saj përgjatë viteve deri në vlerën 3.860.000 (tre milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, sa është deklaruar në deklaratën *vetting*.

**12.6/dh.** Komisioni në konkluzionin përfundimtar në vendim, pasi vlerësoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, që si burim i krijimit të depozitave bankare, që janë investuar në Bono Thesari në vitet 2010 – 2011, kanë shërbyer deklaratimet e gjendjeve *cash* të kursyera në shtëpi, duke filluar nga viti 2007 deri në vitin 2009, i reflektoi ato në analizën financiare të kryer për periudhën 2010 e në vijim dhe arriti në përfundimin se pamundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj për të krijuar pasurinë Bono Thesari do të ishte në vlerën (-) **229.810 (dyqind e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e dhjetë) lekë**.

**12.6/e.** Në deklaratat periodike vjetore, dorëzuar pranë ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit në faqen 3 të formularit, që i dedikohet pasqyrimin të shtesave dhe ndryshimeve të interesave të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, si dhe udhëzohen subjektet deklaruese të shprehen për shtesa dhe pakësime nga *deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklaramit*, ka deklaruar si më poshtë:

- Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Kesh në dorë 500.000 (pesëqind mijë) lekë”.
- Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Kesh në dorë 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë”.
- Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Kesh në dorë 900.000 (nëntëqind mijë) lekë”.
- Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Kesh në dorë 400.000 (katërqind mijë) lekë”.
- Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Pakësuar gjendje cash e deklaruar më parë të deklaruara - 1.300.000 lekë”.

- Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Kesh në dorë 700.000 (shtatëqind mijë) lekë”*.
- Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Kesh në dorë 300.000 (treqind mijë) lekë”*.
- Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Kesh në dorë 700.000 (shtatëqind mijë) lekë”*.
- Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Kesh në dorë 700.000 (shtatëqind mijë) lekë”*.
- Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Kesh në dorë të krijuara nga të ardhurat e mia dhe bashkëshortit 700.000 (shtatëqind mijë) lekë”*.
- Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Kesh në dorë të krijuara nga të ardhurat e mia dhe bashkëshortit 500.000 (pesëqind mijë) lekë”*.
- Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Gjendje cash, kursime nga paga si prokurore dhe e bashkëshortit si mjek 400.000 (katërqind mijë) lekë”*.

**12.6/f.** Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, nga viti 2007 e në vijim, në këtë rubrikë kanë deklaruar kursime të likuiditeteve *cash*, me termin: *“Kesh në dorë”* dhe vetëm në deklaratën periodike të vitit 2011, subjekti ka deklaruar: *“Pakësuar gjendje cash e deklaruar më parë të deklaruara - 1.300.000 lekë”*.

**12.7.** Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk rezultojnë që të kenë deklaruar në deklaratat periodike vjetore përdorimin e kursimeve *cash*, si burim për krijimin e likuiditeteve në llogaritë bankare. Subjekti i rivlerësimit, vetëm në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, ka pretenduar se si burim për krijimin e këtyre likuiditeteve (depozitimeve *cash* në llogaritë bankare, të cilat janë investuar në formën e bonove të thesarit, vendosur pranë Bankës së Shqipërisë), kanë shërbyer kursimet e viteve të mëparshme, disponuar në *cash*. Subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar deklaratimet gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorëve dhe në shpjegimet e dhëna pas kalimit të barrës së provës në raport me deklaratimet e kryera në deklaratat periodike vjetore të gjendjes *cash*, duke i konsideruar ato herë si shtesa, deri në vitin 2011 kur ka deklaruar pakësimin dhe më pas i konsideron si gjendje *cash*. Qëndrimet e mësipërme të subjektit të rivlerësimit vlerësohen nga trupi gjykues jo të besueshme, sepse duken si përpjekje të tij për t'i përshtatur ato me qëllim për të justifikuar mundësinë e krijimit të bonove të thesarit.

**12.7/a.** Pavarësisht nga ky fakt, nga kontrolli i analizës financiare përfundimtare, pasqyruar në vendimin e arsyetuar të Komisionit, konstatohet se në të është reflektuar pakësim i kursimeve në *cash* të subjektit të rivlerësimit edhe për vitet për të cilat ai nuk ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore pakësim të kursimeve në likuiditete *cash*.

**12.8.** Nga sa më lart, trupi gjykues vlerëson se mosdeklarimi nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike të pakësimeve të gjendjes *cash* dhe as të ndonjë destinacioni të përdorimit të kësaj gjendjeje në funksion të krijimit të ndonjë likuiditeti bankar, nuk duhet të konsiderohet si një pasaktësi në deklaratime siç pretendon subjekti, pasi kjo pasqyron një panoramë të situatës

financiare të subjektit, e cila tregon mungesë të burimeve të ligjshme për të përballuar në këto vite kursimet e krijuara dhe shpenzimet e kryera. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit rezulton ta ketë kuptuar drejt ligjin lidhur me mënyrën e deklarimit të shtesave dhe pakësimeve të gjendjes *cash* në deklaratat periodike vjetore, për sa kohë në DPV-në e viti 2011 e ka përdorur saktësisht nocionin e pakësimit të gjendjes *cash*, duke deklaruar: “*Pakësuar gjendje cash e deklaruar më parë të deklaruara - 1.300.000 lekë*”.

**12.9.** Për rrjedhojë, pakësimi i kursimeve në *cash* është reflektuar vetëm në vitin 2011, referuar deklarimit periodik të këtij viti dhe deklarimeve të subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të Komisionit. Referuar edhe jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit<sup>19</sup>, kursimet në likuiditete *cash*, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, nuk mund të konsiderohen si kursim i mbartur dhe i akumuluar në vitet pasardhëse, nëse nga analiza financiare e vitit respektiv nuk rezulton mbulim i kursimeve *cash* me burime të ligjshme.

**12.10.** Në përmbledhje sa analizuar në paragrafët më lart, në lidhje me trajtimin e kursimeve *cash* dhe mbulimin e shpenzimeve me burime të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe pasaktësitë në deklarimin e kursimeve *cash* nga ana e subjektit (në vitet 2010-2016), trupi gjykues konstaton se arsyetimi i Komisionit nuk përputhet me gjendjen që janë aktet në dosje, si dhe me detyrimin ligjor të subjekteve për deklarimin në deklaratat periodike të interesave vjetore, të cilat përbëjnë provë në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe së bashku me deklaratën *vetting* shërbejnë për verifikimin e ekzistencës së tyre dhe përdorimin për krijimin e pasurive të tjera në funksion të procesit të rivlerësimit.

- 13.** Në vlerësimin e trupit gjykues, gjendet i drejtë pretendimi i Komisioneres Publike se analiza financiare e subjektit të rivlerësimit duhet kryer duke llogaritur për çdo vit kursimet në *cash*, në përputhje me deklaratimet në deklaratat periodike vjetore, si shtesa të kursimeve dhe pa pakësuar kursimet e akumuluar në vitet e mëparshme, me përjashtim të rastit kur ato janë deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në vijim të arsyetimit të mësipërm dhe konkluzionit se nuk mund të prezumohet përdorimi nga subjektet i gjendjeve *cash* si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike, trupi gjykues kreu përlllogaritjet sipas viteve përkatëse nga ku rezultoi se:

**13.1.** Për vitin 2007, duke aplikuar rritjen prej 397.392 lekësh si rezultat i rrillogaritjes së shpenzimeve për jetesë, duke pasur ndryshim në shtesën e likuiditeteve më pak prej 171.345 lekësh<sup>20</sup>, duke korigjuar të ardhurat nga interesat e depozitave sipas statement të depozitave

<sup>19</sup> Referohuni vendimit (JR) nr. 18/2022 të Kolegjit, prg. 31.2.

<sup>20</sup> Shtesa e likuiditeteve prej 1.120.599 lekësh, e cila përfshin: (a) shtesë likuiditeti *cash* prej 500.000 lekësh, ashtu si Komisioni dhe Komisionerja Publike që shprehet me narrativë; (b) shtesë likuiditeti në banka prej 620.599 lekësh (ndryshe nga Komisioni që ka pasur 791.944 lekë), nga balanca fund vitit 2007 prej 6.787.879 lekësh [në krahasim me Komisionin që ka pasur balancë prej 6.837.357 lekësh, ndryshim prej (-) 49.478 lekë, e cila duket se vjen nga balancat e depozitave në OTP Bank që janë investuar në vitin 2005 e 2006 e janë maturuar së bashku me interesat në vitin 2008, e Komisioni ka konsideruar se balanca e maturuar në vitin 2008 ka qenë gjendje në vitin 2007. Në Kolegj janë konsideruar me rritje progresive me interesat e përfituara gjatë viteve respektive sipas statament bankar sjellë nga subjekti në ILDKPKI bashkëlidhur deklaratës *vetting*] me balancën në fund vitin 2006 prej 6.167.280 lekë [në krahasim me Komisionin që ka pasur balancë prej 6.045.413 lekësh, ndryshim prej (-) 121.867 lekësh, e cila duket se më së shumti vjen nga balancat e depozitave në OTP Bank që janë investuar në

në OTP (ish-Societe General Bank)<sup>21</sup> e duke lënë elementët e tjerë të analizës financiare të vitit 2007 ashtu si Komisioni, diferenca negative prej (-) 416.416 lekësh e rezultuar në Komision do të ndryshohej, balanca negative do të thellohej dhe subjekti do të kishte mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën prej (-) 635.303 lekësh.

**13.2.** Për vitin 2008, duke pasur ndryshim në pakësimin e likuiditeteve më pak prej 49.494 lekësh<sup>22</sup> e duke lënë elementët e tjerë në analizë si Komisioni, subjekti i rivlerësimit rezulton me diferencë negative prej (-) 26.622 lekësh (në dallim nga rezultati pozitiv në Komision prej (+) 22.872 lekësh). Pra, në këto kushte, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e vitit, shtesën në likuiditete bankare dhe shtimin e likuiditetit *cash* të deklaruar prej 600.000 lekësh.

**13.3.** Për vitin 2010, duke konsideruar se likuiditeti *cash* në këtë vit është shtuar me 400.000 lekë, ashtu sikur është deklaruar në DPV-në 2010, pra, duke pasur ndryshim në shtimin e elementit në analizën totale “Shtesa/Pakësime likuiditete” më shumë + 1.000.000 lekë<sup>23</sup>, duke korrigjuar të ardhurat nga interesat e bonove të thesarit sipas kartelave të klientit sjellë nga Banka e Shqipërisë<sup>24</sup> e duke lënë elementët e tjerë në analizë si Komisioni, subjekti rezulton me diferencë negative prej (-) 387.108 lekësh [në dallim nga rezultati pozitiv në Komision prej (+) 613.892 lekësh]. Pra, në këto kushte, subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e vitit, shtesën në likuiditete bankare dhe shtimin e likuiditetit *cash* të deklaruar prej 400.000 lekësh.

**13.4.** Për vitin 2011, duke konsideruar se likuiditeti *cash* në këtë vit është pakësuar me (-) 1.300.000 lekë, ashtu si deklaruar në DPV-në 2011, e jo si konkluduar nga Komisioni, pra, duke pasur ndryshim në shtimin e elementit në analizën totale “Shtesa/Pakësime likuiditete” më shumë + 100.000 lekë<sup>25</sup>, duke korrigjuar të ardhurat nga interesat e bonove të thesarit sipas

---

*vitin 2005 e 2006 e janë maturuar së bashku me interesat në vitin 2008 dhe, gjithashtu, në Kolegj janë konsideruar me rritje progresive me interesat e përfituara gjatë viteve respektive, sipas statament bankar sjellë nga subjekti në ILDKPKI bashkëlidhur deklaratës vetting].*

<sup>21</sup> *Duke i korrigjuar në vlerën prej 292.036 lekësh, më shumë se Komisioni prej 7.160 lekësh, sipas statament bankar sjellë nga subjekti në ILDKPKI bashkëlidhur deklaratës vetting.*

<sup>22</sup> *Pakësim i likuiditeteve prej (-) 5.888.725 lekësh, e cila përfshin: (a) shtesë likuiditeti cash prej 600.000 lekësh, ashtu si Komisioni dhe Komisionerja Publike që shprehet me narrativë; (b) pakësim likuiditeti në banka prej (-) 6.488.725 lekësh (ndryshe nga Komisioni që ka pasur (-) 6.538.219 lekë), nga balanca fund vitit 2008 prej 299.154 lekësh [në krahasim me Komisionin që ka pasur balancë prej 299.138 lekësh, ndryshim prej (-) 16 lekësh, e cila duket se vjen se Komisioni nuk ka konsideruar balancat në llogaritë në Raiffeisen Bank të subjektit e bashkëshortit në total prej 16 lekësh] me balancën në fund vitin 2007 prej 6.787.879 lekësh [në krahasim me Komisionin që ka pasur balancë prej 6.837.357 lekësh, ndryshim prej (-) 49.478 lekësh, e cila duket se vjen nga balancat e depozitave në OTP Bank që janë investuar në vitin 2005 e 2006 e janë maturuar së bashku me interesat në vitin 2008 e Komisioni ka konsideruar se balanca e maturuar në vitin 2008 ka qenë gjendje në vitin 2007, por në Kolegj janë konsideruar me rritje progresive me interesat e përfituara gjatë viteve respektive sipas statament bankar sjellë nga subjekti në ILDKPKI bashkëlidhur deklaratës vetting].*

<sup>23</sup> *Komisioni ka shtuar vlerën prej 287.348 lekësh, kurse në analizën në Kolegj u shtua vlera prej 1.287.348 lekësh, e cila përfshin: (a) shtesë likuiditeti cash prej 400.000 lekësh, ashtu si deklaruar në DPV e analizën në rezultatet e hetimit në Komisioni dhe sikurse pretendon Komisionerja Publike në ankim me narrativë dhe jo si analiza finale e Komisionit që ka konsideruar pakësim (-) 600.000 lekë; (b) shtim likuiditeti në banka prej +887.348 lekësh, ashtu si dhe në analizën e Komisionit.*

<sup>24</sup> *Korrigjuar në vlerën prej 72.329 lekësh nga 73.329 lekë konsideruar në analizën e Komisionit, më pak prej 1.000 lekësh, sipas lëvizjes së llogarisë në Bankën e Shqipërisë sjellë bashkëlidhur shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 26.12.2023 e interesat e përfituara janë sipas lëvizjeve bankare në të cilën emërtohen “Pagesa në cash për individë”, sipas viteve përkatëse dhe shumave të tyre (pra, më pak prej 1.000 lekësh nga Komisioni).*

<sup>25</sup> *Komisioni ka shtuar vlerën prej 230.498 lekësh, kurse në analizën në Kolegj u shtua vlera prej +330.498 lekësh, e cila përfshin: (a) pakësim likuiditeti cash prej (-) 1.300.000 lekësh, ashtu si deklaruar në DPV e analizën në*

kartelave të klientit sjellë nga Banka e Shqipërisë<sup>26</sup> e duke lënë elementët e tjerë në analizë si Komisioni, subjekti i rivlerësimit rezulton me diferencë negative prej (-) 113.502 lekësh [në dallim nga rezultati negativ i Komisionit prej (-) 11.502 lekësh]. Pra, në kushtet e një difference negative, subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e vitit, shtesën në likuiditete bankare dhe me pakësimin e likuiditetit *cash* të deklaruar në vlerën prej 1.300.000 lekësh.

**13.5.** Për vitin 2012, duke korigjuar elementin në analizën totale “*Shtesa/Pakësime likuiditete*” më pak prej (-) 17 lekësh<sup>27</sup>, duke korigjuar të ardhurat nga interesat e bonove të thesarit sipas kartelave të klientit sjellë nga Banka e Shqipërisë<sup>28</sup> e duke lënë elementët e tjerë në analizë si Komisioni, subjekti i rivlerësimit rezulton me diferencë negative prej (-) 220.292 lekësh [në dallim nga rezultati negativ i Komisionit në vlerën prej (-) 218.308 lekësh]. Pra, në kushtet e një difference negative, subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e vitit, shtesën në likuiditete bankare dhe shtimin e likuiditetit *cash* të deklaruar prej 700.000 lekësh.

**13.6.** Për vitin 2014, duke konsideruar se likuiditeti *cash* në këtë vit është shtuar me 700.000 lekë, ashtu si deklaruar në DPV-në 2014, e jo si konkluduar nga Komisioni, pra, duke pasur ndryshim në shtimin e elementit në analizën totale “*Shtesa/Pakësime likuiditete*” më shumë + 300.000 lekë<sup>29</sup>, duke korigjuar të ardhurat nga interesat e bonove të thesarit sipas kartelave të klientit sjellë nga Banka e Shqipërisë<sup>30</sup> e duke lënë elementët e tjerë në analizë si Komisioni, subjekti i rivlerësimit rezulton me diferencë negative prej (-) 219.864 lekësh [në dallim nga rezultati pozitiv i Komisionit prej (+) 82.137 lekësh]. Pra, në kushtet e një difference negative, subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e vitit, shtesën në likuiditete bankare dhe shtimin e likuiditetit *cash* të deklaruar prej 700.000 lekësh.

---

*rezultatet e hetimit në Komision dhe sikurse pretendon Komisionerja Publike në ankim me narrativë dhe jo si analiza finale e Komisionit që ka konsideruar pakësim (-) 1.400.000 lekësh; (b) shtim likuiditeti në banka prej +1.630.498 lekësh, ashtu si dhe në analizën e Komisionit.*

<sup>26</sup> *Korigjuar në vlerën prej 161.130 lekësh nga 163.130 lekë konsideruar në analizën e Komisionit, më pak prej 2.000 lekësh, sipas lëvizjes së llogarisë në Bankën e Shqipërisë sjellë bashkëlidhur shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 26.12.2023 e interesat e përfituara janë sipas lëvizjeve bankare në të cilën emërtohen “Pagesa në cash për individë”, sipas viteve përkatëse dhe shumave të tyre (pra, më pak prej 2.000 lekë).*

<sup>27</sup> *Komisioni ka shtuar vlerën prej 1.536.180 lekësh, kurse në analizën në Kolegj u shtua vlera prej +1.536.163 lekësh, e cila përfshin: (a) shtim likuiditeti cash prej 700.000 lekësh, ashtu si deklaruar në DPV, e analizën e Komisionit dhe sikurse pretendon Komisionerja Publike në ankim me narrativë; (b) shtim likuiditeti në banka prej + 836.163 lekësh në dallim nga Komisioni që ka shtim prej 836.180 lekësh, pra, + 17 lekë diferencë..*

<sup>28</sup> *Duke i korigjuar në vlerën prej 182.936 lekësh nga 184.937 lekë konsideruar në analizën e Komisionit, më pak prej 2.000 lekësh, sipas lëvizjes së llogarisë në Bankën e Shqipërisë sjellë bashkëlidhur shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 26.12.2023 e interesat e përfituara janë sipas lëvizjeve bankare në të cilën emërtohen “Pagesa në cash për individë”, sipas viteve përkatëse dhe shumave të tyre (pra, më pak prej 2.000 lekësh).*

<sup>29</sup> *Komisioni ka shtuar vlerën prej 537.475 lekësh, kurse në analizën në Kolegj u shtua vlera prej +837.475 lekësh, e cila përfshin: (a) shtim likuiditeti cash prej 700.000 lekësh, ashtu si deklaruar në DPV, e analizën në rezultatin e hetimit në Komision dhe sikurse pretendon Komisionerja Publike në ankim me narrativë dhe jo si analiza finale e Komisionit që ka konsideruar shtim 400.000 lekë në mënyrë që t’i qëndrojë logjikës se vlera deklaruar 700.000 lekë është gjendje e likuiditeteve cash në vitin 2014 e jo shtesë e vitit; (b) shtim likuiditeti në banka prej + 137.475 lekësh njësoj si Komisioni.*

<sup>30</sup> *Korigjuar në vlerën prej 95.818 lekësh nga 97.819 lekë konsideruar në analizën e Komisionit, më pak se prej 2.000 lekësh, sipas lëvizjes së llogarisë në Bankën e Shqipërisë sjellë bashkëlidhur shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 26.12.2023 e interesat e përfituara janë sipas lëvizjeve bankare në të cilën emërtohen “Pagesa në cash për individë”, sipas viteve përkatëse dhe shumave të tyre (pra, më pak prej 2.000 lekë).*

14. Për sa kohë në deklaratat periodike subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar si burim krijimi të likuiditeteve bankare këto kursime dhe as si pakësim të gjendjes *cash* të deklaruar në deklaratat përkatëse (duke përfshirë deklarimin në vitin 2011), trupi gjykues vlerëson se Komisioni nuk duhej të prezumonte përdorimin e këtij likuiditeti, gjatë të cilit rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka krijuar llogarinë bankare. Ky vlerësim i situatës faktike nga Komisioni ka sjellë si pasojë një vlerësim të gabuar të situatës financiare të subjektit të rivlerësimit gjatë viteve 2010 – 2016, kur janë krijuar pjesa më e madhe e depozitave bankare të investuara në formën e bonove të thesarit.
15. Komisionerja Publike, pasi ka kontrolluar analizën financiare përfundimtare të Komisionit<sup>31</sup>, ka vërejtur se në analizimin e burimeve të ligjshme të vitit 2004, në zërin e të ardhurave, Komisioni ka përfshirë në nënzërin “*Mundësi për kursim*”, shumën prej 1.439.534 lekësh<sup>32</sup>, pasi ka vlerësuar pretendimet e subjektit se në *DPV-në 2003, pavarësisht se duhej deklaruar gjendja e pasurive në datën 31.12.2003, nga ana e subjektit është deklaruar gjendja e depozitave të kursimit/likuiditetit në atë kohë në Bankën e Kursimeve në datën 17.03.2004*. Komisionerja Publike, në kundërshtimin e kësaj analize të kryer nga Komisioni, sjell në vëmendje qëndrimin e mbajtur nga Kolegji për mosdeklarimet me korrektësi në vite të subjektit të rivlerësimit dhe mënyrën se si e afektojnë procesin e tij të rivlerësimit në drejtim të pamundësisë së verifikimit të vërtetësisë së deklarimeve në deklaratën *vetting*, të cilat prezumoheshin për shkak të ligjit se duhej të mbështeteshin e provoheshin me anë të deklarimeve në deklaratat periodike.

15.1. Për sa më lart, trupi gjykues vëren se Komisionerja Publike nuk e ngre këtë pretendim si një shkak të mirëfilltë ankimi, si dhe nuk duket se i jep ndonjë pasojë konkrete subjektit të rivlerësimit, por e sjell në vëmendje të Kolegjit për ta mbajtur në konsideratë në kontrollin e analizës financiare për vitin 2004. Trupi gjykues, me qëllim kontrollin mbi mënyrën e kryerjes së analizës financiare të Komisionit për vitin 2004, edhe pse nuk ka kërkim të posaçëm në ankim, mori në shqyrtim dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, deklaratat e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike të interesave pasurore ndër vite, si dhe shpjegimet e tij dhe konstatoi se:

15.2. Në vendimin e tij Komisioni, për deklarimin në *DPV-në* e vitit 2003 të depozitës në emër të bashkëshortit të subjektit në vlerën 1.868.587 (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë, ndër të tjera, ka arsyetuar se: *Kemi të bëjmë me pasaktësi dhe mosnjohje të saktë të procesit të deklarimit, duke qenë se e njëjta situatë paraqitet edhe në deklarimin e vitit 2004, ku subjekti ka deklaruar gjendjen e likuiditeteve deri në mars të vitit 2005 dhe jo deri në dhjetor të vitit 2004, siç kërkohet nga ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar.*

15.3. Në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie në vitin 2003, në formularin A-5, në rubrikën “Likuiditete” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: 1. “*M. L., vlefte*

---

<sup>31</sup> Referohuni faqes 18 të vendimit të Komisionit.

<sup>32</sup> Komisioni ka vlerësuar pretendimet e subjektit se në deklaratën periodike të vitit 2003, pavarësisht se duhej deklaruar gjendja e pasurive në datën 31.12.2003, nga ana e subjektit është deklaruar gjendja e depozitave të kursimit/likuiditetit në atë kohë në Bankën e Kursimeve në datën 17.03.2004.

*1.868.587 lekë, nr. 6670, Banka e Kursimeve Gramsh, të ardhura nëpërmjet pagës mujore, si dhe një pjesë e vogël të dhuruara nga vëllai i tij në Amerikë”. 2. “Zena P. Lila, vlefte 467.278 lekë, Banka e Kursimeve Gramsh, të ardhurat nëpërmjet pagës mujore”.*

**15.4.** Nga verifikimi i llogarisë bankare në Raiffeisen Bank rezulton që gjendja e likuiditeteve gjatë këtij viti të jetë 1.221.924 lekë. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DPV-në 2003 se deri në datën 31.12.2003, gjendja e likuiditeteve bankare është në vlerën totale 2.344.865 lekë. Sikurse konstatohet, deklarimi i subjektit nuk përputhet me gjendjen e llogarisë sipas informacionit të përcjellë nga Raiffeisen Bank.

**15.5.** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka pretenduar se ka pasur pasaktësi në deklaratimet periodike të viteve 2003-2004 mbi likuiditetet e disponuara në llogaritë bankare, të cilat kanë ardhur si rezultat i paqartësisë lidhur me mënyrën e deklarimit, duke shpjeguar se dokumentet bankare, të cilat i janë bashkëlidhur deklaratës *vetting*, vërtetojnë faktin që në deklaratën e parë të pasurisë nuk është deklaruar gjendja e llogarive bankare më 31.12.2003, por ajo në datën 17.03.2004.

**15.6.** Komisioni ka konstatuar se kjo pasaktësi nuk është bërë me qëllim për të fshehur gjendjen e pasurisë së subjektit dhe nuk afekton ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj shume. Për këtë arsye, Komisioni gjykoj të përfshijë në analizën financiare gjendjen e likuiditeteve, sipas dokumentacionit të paraqitur gjatë hetimit administrativ, duke konsideruar edhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit mbi pasaktësitë në deklaratim, të dhëna në prapësimet e rezultateve të hetimit. Nga kjo analizë ndryshoi gjendja e likuiditeteve të subjektit gjatë vitit 2004, duke afektuar edhe gjendjen e subjektit në vijim konkretisht.

**15.7.** Komisioni, pas prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, rishikoi analizën financiare dhe për vitin 2004 konsideroi, ndër të tjera, edhe saktësimin e balancave të llogarive bankare në vitin 2004. Në analizën në raportin e rezultateve hetimore, balanca totale në fund të vitit 2004 ishte 1.770.533 lekë (shtuar me + 648.609 lekë nga balanca e fund vitit 2003), në analizën përfundimtare në Komision, kjo balancë u saktësua dhe ishte 3.022.595 lekë (shtuar me + 1.900.671 lekë nga balanca fund vitit 2003).

**15.8.** Në analizën finale të vitit 2004 në vendim, Komisioni, përveç ndryshimit të saktësimit të balancave të llogarive, ka shtuar dhe një element në analizë “Mundësi për kursim” prej 1.439.534 lekësh. Kjo vlerë është rezultati i analizës akumulative nga 1993-2003, e cila ka rezultuar me diferencë pozitive prej + 1.439.534 lekësh. Komisioni e ka konsideruar këtë “Mundësi për kursim” prej 1.439.534 lekësh (si kursimet e krijuara deri më 31.12.2003 dhe të përdorura në 2004 dhe pse nuk ka deklarime nga ana e subjektit të rivlerësimit në DPV-të përkatëse).

**15.9.** Bazuar në ligjin nr. 9049/2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, në nenin 4, germa “d”, parashikohet se: *“Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në ILDKPKI vlerën e likuiditeteve, gjendjen cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj”.* Sipas kësaj dispozite, subjekti i rivlerësimit duhej të deklaronte vit pas viti gjendjen e likuiditeteve, për të mundësuar në këtë mënyrë kontrollin e pasurisë së tij. Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: *“Deklarimet e interesave*

*privatë dhe pasurorë të paraqitura më parë te ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit*”. Gjithashtu, në formularin A-5, në rubrikën “Likuiditete” të deklaratës që mbart detyrimin për deklarim pasurie të vitit 2003, subjekti ka plotësuar si periudhë deklarimi *deri më 31.12.2003*.

Nga sa më lart, megjithëse subjekti i rivlerësimit, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, kishte detyrimin të deklaronte pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, gjendjen e likuiditeteve deri në fund të vitit dhe jo deri në momentin e plotësimit të deklaratës periodike të vitit 2003, trupi gjykues çmon se kjo pasaktësi në mënyrën e deklarimit të subjektit në deklaratën periodike vjetore nuk e ngarkon me përgjegjësi të tillë që të ndikojë më pas në vlerësimin e tij.

**15.10.** Në kushtet kur Komisioni në vendim, në zërin e të ardhurave, ka përfshirë nënzërin “*Mundësi për kursim*”, në shumën 1.439.534 lekë (bazuar në kursime të mundshme të krijuara deri në fund të vitit 2003, të pa deklaruar, por të përdorura për krijimin e likuiditeteve bankare), trupi gjykues, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, kontrolloi analizën financiare të Komisionit për rezultatin e vitit 2004 të sjellë në vëmendje të Kolegjit nga Komisionerja Publike dhe kreu përlllogaritjet duke mos konsideruar pretendimin e subjektit se *në deklarimin e DPV-së 2003, pavarësisht se duhej deklaruar gjendja e pasurive në datën 31.12.2003, është deklaruar gjendja e depozitave të kursimit/likuiditetit në atë kohë në Bankën e Kursimeve në datën 17.03.2004* dhe i rezultoi se për vitin 2004, subjekti i rivlerësimit kishte një diferencë negative prej (-) 938.013 lekësh.

16. Trupi gjykues konstaton se për pasurinë depozitë bankare në Bankën e Shqipërisë – Bono Thesari në vlerën 3.860.000 (tre milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, pamjaftueshmëria financiare për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, për vitet e analizuar, rezulton e ndryshme nga pamjaftueshmëria e konstatuar nga Komisioni në funksion të rivlerësimit të zërave: (i) shpenzime jetese për vitin 2007; dhe (ii) kursime në *cash* ndër vite.
17. Si rezultat i kryerjes së kontrollit në Kolegji të analizës financiare në vendimin e Komisionit, në vijim të pretendimeve të ngritura në ankim, bazuar në argumentet e mësipërme, rezulton se përveç pamjaftueshmërisë financiare, konstatuar për krijimin e likuiditeteve në vitin 2005, në shumën (-) 1.100.000 lekë, rezulton dhe pamjaftueshmëri financiare për periudhën 2007 - 2016, përkatësisht për vitet 2007, 2008, 2010 – 2012 dhe 2014, në vlerën (-) 1.650.803 lekë. Për sa më lart, vlera negative nuk mund t’i nënshtrohet parimit të proporcionalitetit të parashikuar nga neni 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe nuk arrin nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë.
18. Në përfundim, trupi gjykues, mbështetur në konkluzionin e arritur për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, çmon se ankimi i paraqitur prej Komisioneres Publike është i drejtë dhe, për pasojë, vendimi nr. 729, datë 10.01.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Zena Lila, është një vendim, i cili nuk është marrë në vlerësim të drejtë të provave të administruara gjatë hetimit administrativ e as në zbatim të drejtë të dispozitave ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit dhe, si i tillë, ai duhet të ndryshohet.



## **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

### **VENDOSI:**

1. Ndryshimin e vendimit nr. 729, datë 10.01.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Zena Lila.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 19.09.2024.

#### **ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

#### **ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

#### **RELATORE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

#### **KRYESUESE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi-kundër*

## MENDIM NË PAKICË

1. Unë gjyqtare **Ina Rama**, kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues, për sa i takon çështjes që i përket ankimit të Komisioneres Publike Irena Nino, kundër vendimit nr. 729, datë 10.01.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që ka vendosur ndryshimin e këtij vendimi dhe shkarkimin nga detyra të subjekti të rivlerësimit, znj. Zena Lila, për arsytet e mëposhtme.
2. Siç rezulton edhe nga vendimi i marrë nga shumica, shkaqet e ankimit të ngritura prej Komisioneres Publike i referohen verifikimit të burimeve të ligjshme për krijimin e dy pasurive të subjektit të rivlerësimit, një apartamenti të ndodhur në Tiranë me sipërfaqe 99,9 m<sup>2</sup>, të blerë në vitin 2008 me çmimin prej 61.480 eurosh dhe të një vlere prej 3.860.000 lekësh Bono Thesari, të deklaruara prej subjektit në deklaratën *vetting* e të krijuara në vite. Shumica ka pranuar si të drejta shkaqet e ankimit të ngritura dhe ka konkluduar se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e tyre në vlerën totale prej 2.600.0000 lekësh.
3. Lidhur me këto shkaqe dhe analizën që ka bërë shumica për të arritur te kjo vlerë e balancës negative, kam pasur një vlerësim të ndryshëm, sipas së cilit balanca negative ka rezultuar jo në vlerën e pranuar prej shumicës. Në vijim, kam vlerësuar se në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit subjekti duket se e kalon testin e nivelit të besueshëm të kriterit të pasurisë, për pasojë vendimi i Komisionit duhej të lihej në fuqi, ndonëse me një arsyetim të ndryshëm.

### *Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë apartament*

4. *Së pari*, lidhur me burimin e krijimit të pasurisë apartament të ndodhur në Tiranë dhe moskonsiderimin si të ligjshëm të shumës prej 1.100.000 lekësh, të deklaruar nga subjekti si burim për krijimin e saj në deklaratën *vetting*, kam bërë një vlerësim të ndryshëm për sa i përket peshës që mungesa e provueshmërisë së kësaj shume si e ardhur e ligjshme duhet të ketë në vlerësimin e kriterit të pasurisë.

4.1. Përveç sa shumica ka përmendur në vendimin e saj lidhur me krijimin e kësaj shume, në vlerësimin tim kam mbajtur në konsideratë edhe disa elementë, të cilët dobësojnë një qëndrim kategorik rreth paligjshmërisë/mungesës së këtij burimi për krijimin e pasurisë apartament.

4.2. Rezulton se subjekti e ka deklaruar këtë shumë si burim krijimi të kësaj pasurie në deklaratën *vetting*, në të cilën ajo është thirrur me përgjegjësi për të identifikuar plotësisht dhe qartësisht burimet e krijimit të pasurive, sipas përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si edhe nenit 30 e vijues të ligjit nr. 84/2016.

4.3. Hetimi i Komisionit ka synuar drejt përcaktimit të vërtetësisë së këtij deklarimi, duke konkluduar në fund se ky burim mbetet deklarativ dhe nuk mund të jetë përdorur për krijimin e kësaj pasurie. Ndonëse në një këndvështrim formal, ky qëndrim i Komisionit duket i paqortueshëm, në vlerësimin tim, analiza e situatës meritonte një vlerësim më të kujdesshëm për të sjellë në vëmendje disa elementë që duhen konsideruar në drejtim të peshës që ky konkluzion duhet të ketë në raport me vlerësimin e kriterit të pasurisë.

4.4. Në këtë kontekst, sjell në vëmendje që subjekti ka qenë koherente me këtë deklaram në çdo përgjigje që ka dhënë gjatë hetimit. Ajo ka përcaktuar se kjo shumë i korrespondon shitjes së një pjese të pronës bashkëngjitur shtëpisë dhe truallit që familja e saj zotëronte në qytetin e Gramshit, e cila është kaluar në pronësi të blerësit G.B., në muajin shkurt 2005. Gjithashtu, ka deklaruar se kjo shumë nuk është përfshirë në kontratën e shitjes së pasurisë, e cila ka përcaktuar si çmim vetëm shumën prej 500.000 lekësh, dhe që i korrespondon vetëm pjesës së pasurisë së regjistruar në regjistrat publikë dhe jo shumën prej 1.100.000 lekësh që i korrespondonte shitjes së pasurisë bashkëlidhur, por e zotëruar në mënyrë informale.

4.5. Përveç këtyre shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ, subjekti rezulton të këtë deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2004, krijimin e depozitës në Bankën e Kursimeve në vlerën prej 2.300.000 lekësh edhe për shkak të shitjes së shtëpisë më 01.02.2005. Ndonëse shitja e pasurisë në këtë vit nuk është deklaruar në mënyrë të plotë, duke përfshirë të gjithë ekstremitetet e nevojshme që identifikonin veprimin juridik as edhe në deklaratën periodike të vitit 2005, kur ajo duhej ligjërisht të ishte përfshirë si deklaram, rezulton sërish se subjekti ka lënë gjurmë për këtë veprim, gjithsesi të dokumentueshëm në regjistrat publikë të pasurisë.

4.6. Krijimi i kësaj depozite siç rezulton nga dokumentacioni bankar i referohet depozitimit në depozitat bankare në datën e shitjes së shtëpisë në Gramsh, më datë 01.02.2005, nga bashkëshorti i subjektit M.L., të një shume prej 1.700.000 lekësh, nga të cilat subjekti pretendon se vlera prej 1.600.000 lekësh janë të ardhura të krijuara prej shitjes së kryer po në këtë datë. Ndonëse subjekti nuk ka arritur të provojë se transaksioni mes bashkëshortit dhe blerësit është bërë në rrugë bankare, siç ka pretenduar, sepse nuk janë gjetur gjurmë të tilla, ka rezultuar e provuar se në ditën e kryerjes së depozitimit në bankë të shumës prej 1.700.000 lekësh është lidhur edhe kontrata e shitblerjes së pasurisë që subjekti deklaroi se ka krijuar këto të ardhura<sup>33</sup>.

4.7. Në këto kushte, duke konsideruar deklaramet e subjektit dhe gjurmët bankare që provojnë ekzistencën e shumës së pretenduar se ka ardhur nga shitja e pasurive informale, por edhe profilin e subjektit në drejtim të pasurive të krijuara, të cilat rezultojnë të jenë modeste, pavarësisht angazhimit në marrëdhënie pune të të dy bashkëshortëve për vite, kohën e krijimit të kësaj shume, si edhe dokumentimin e saj nëpërmjet derdhjes së të ardhurave në sistemin bankar, lehtësisht të gjurmueshme, kam krijuar bindjes se shuma e pretenduar prej 1.100.000 lekësh është krijuar vërtetë nga shitja e pasurisë, që lidhet me shtëpinë e banimit dhe truallin të ndodhur në Gramsh, ndonëse ajo nuk është përcaktuar si çmim në të njëjtën vlerë të pretenduar në kontratën e shitjes në vitin 2005.

4.8. Në këtë kontekst, ndonëse mbetet e paqartë nëse shuma prej 1.100.000 lekësh i përket shitjes së një pjese informale të pasurisë apo çmimit real të asaj pasurie që është regjistruar, i cili mund të jetë shmangur nga përcaktimi si i tillë në kontratë për efekt të uljes së vlerës së detyrimit tatimor, jam bindur se kjo vlerë ka buruar gjithsesi nga ky transaksion dhe jo nga burime të tjera të paligjshme që lidhen me ushtrimin e funksioneve të subjektit si prokurore.

4.9. Analiza e mësipërme, pavarësisht, nuk ndryshon qëndrimin tim, ashtu si edhe shumicës së trupit gjykues se këto të ardhura, për të cilat në çdo version nuk janë paguar detyrimet tatimore,

---

<sup>33</sup> Paragrafët 17.32 dhe 17.33, të vendimit të Komisionit.

nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, i jam bashkuar konkluzionit të Komisionit dhe shumicës për sa i përket mungesës së burimeve të financimit të pasurisë apartament në vlerën prej (-) 1.100.000 lekësh, e cila në vijim është vlerësuar prej meje nën dritën e arsytimit të mësipërm, lidhur me peshën që ajo duhet të ketë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.

### ***Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë bono thesari***

5. Lidhur me shkakun tjetër të ankimit, që i referohet analizës së burimeve për krijimin e pasurisë Bono Thesari të deklaruara në deklaratën *vetting* në vlerën prej 3.860.000 lekësh, kam ndarë një qëndrim të ndryshëm nga shumica e trupit gjykues, për sa i përket analizës së përdorimit kursimeve në gjendje *cash* për krijimin në vite të këtyre bonove, për shkak të së cilës, balanca negative për mundësinë e krijimit të tyre rezulton në një vlerë më të ulët se ajo që ka konkluduar shumica në vendimin e saj, sipas arsytimit të mëposhtëm.

5.1. Subjekti i rivlerësimit ka filluar të deklarojë krijimin e kësaj pasurie që në deklaratën periodike të vitit 2010 e ka vijuar më pas me deklarimin e shtesave në vitet 2011, 2012, 2013 e 2017. Në deklaratat periodike të këtyre viteve, subjekti ka deklaruar krijimin e likuiditeteve në Bono Thesari pa përcaktuar burimin e krijimit të tyre, me përjashtim të vitit 2013, në të cilin ka deklaruar se *depozita në bono është krijuar nga pagat*. Krahas krijimit të kësaj pasurie rezulton se subjekti ka deklaruar në secilin prej këtyre viteve edhe shtesa në likuiditet në gjendje *cash*.

5.2. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të barrës së provës, subjekti ka shpjeguar se depozitat në Bono Thesari, në Bankën e Shqipërisë, janë krijuar nëpërmjet përdorimit të likuiditeteve në *cash* që ajo kishte akumuluar dhe deklaruar vit pas vit në banesë. Komisioni e ka pranuar si të besueshme këtë logjikë dhe mbi të ka ndërtuar një analizë tjetër financiare, e cila ka rezultuar me balancën negative të pasqyruar në Komision e vlerësuar prej tij se nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit.

5.3. Në gjykimin e çështjes në Kolegj, u mor në shqyrtim pretendimi i Komisioneres Publike se kjo mënyrë e të kontrolluarit të burimeve të krijimit të kësaj pasurie nuk është në përputhje me ligjin dhe se analiza duhej të ndërtohej duke mos u konsideruar përdorimi i gjendjes *cash* në krijimin e depozitave, pretendim i cili u vlerësua i drejtë edhe nga shumica e trupit gjykues, dhe prodhoi për subjektin e rivlerësimit balancën negative të pasqyruar në vendim.

5.4. Kam vlerësuar se në rastin konkret interpretimi i përdorimit të *cash*-it, për të krijuar këtë pasuri, duhet të ishte i ndryshëm, edhe në konsekuencë të qëndrimeve të mbajtura në çështjet të tjera<sup>34</sup> me rrethana të ngjashme, por jo vetëm.

5.5. *Së pari*, subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën *vetting* duke përcaktuar si burim të krijimit të saj kursimet nga pagat dhe duke plotësuar në këtë mënyrë detyrimin për të përcaktuar burimin e krijimit të pasurisë. Në vlerësimin tim, detyra e organeve të rivlerësimit në këto raste është të verifikojnë nëse burimet e përcaktuara si të tilla në deklaratën *vetting* kanë ekzistuar, janë të ligjshëm dhe besohen se janë përdorur sipas deklarimit të subjektit.

---

<sup>34</sup> Shih vendimet e Kolegjit (JR) nr. 28/2022, që i përket subjektit të rivlerësimit L.D., dhe (JR) nr. 6/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit L.H.

5.6. Patjetër që dokumenti primar në të cilin duhet të gjejë pasqyrim kjo situatë është deklarata periodike, siç edhe Kolegji ka tashmë përcaktuar në jurisprudencën e tij, veçanërisht e rëndësishme për të provuar gjendjen e likuiditeteve në *cash* dhe mënyrën e përdorimit të tyre. Referuar deklaratave periodike, rezulton se subjekti ka deklaruar shtesat në likuiditete në gjendje *cash*, duke filluar që nga viti 2007 e në vijim deri në vitin 2017, në vlerat përkatëse. Rezulton të ketë deklaruar pakësime të gjendjes *cash* vetëm në vitin 2011, në vlerën prej 1.300.000 lekësh.

5.7. Nga analiza e akteve rezulton se Komisioni, por edhe Komisionerja Publike, nuk kanë gjetur problematika për sa i përket përdorimit të kursimeve në *cash* për krijimin e pasurisë apartament, të deklaruara si të tilla vetëm në deklaratën *vetting* prej subjektit dhe jo në deklaratat periodike, por i ka njohur dhe verifikuar ato sipas mundësisë së krijimit të tyre, për efekt të pagimit të këstit të apartamentit në vitin 2008. Në ndryshim nga ky qëndrim, Komisionerja Publike ka ngritur pretendimin se këto kursime nuk mund të konsiderohen se janë përdorur prej subjektit për krijimin e depozitave në Bono Thesari, për të cilat po njësoj subjekti ka deklaruar burimin *kursime* në deklaratën *vetting*, por pa bërë deklarime të tilla në deklaratat periodike.

5.8. Në këtë kontekst, kam vlerësuar se, jo vetëm që situatat janë të ngjashme dhe duhen trajtuar me të njëjtën logjikë, veçanërisht brenda të njëjtës çështjes, për shkak se tipologjia e deklarimeve i përket së njëjtit subjekt, por edhe sepse në thelb qëndron verifikimi i burimeve të krijimit të një pasurie, sipas deklarimit të tyre në deklaratën *vetting*.

5.9. Kjo mënyrë e interpretimit të deklarimit të subjektit në vitet 2010-2012, sigurisht që është relevante në kushtet kur subjekti ka deklaruar kursimet si burim të krijimit të depozitave në deklaratën *vetting*, ka deklaruar në çdo vit depozitat në Bono Thesari, si edhe ka deklaruar kursime *cash* në vitet respektive, të cilat në këtë logjikë duhen kontrolluar nëse ishin krijuar me burime të ligjshme dhe a mund të justifikonin krijimin e bonove të thesarit.

5.10. Arsyetimin e përdorur nga shumica se subjekti ka kuptuar ligjin saktë dhe ka pasur nocionin e pakësimit të gjendjes *cash*, duke qenë se ajo ka deklaruar pakësim të kësaj gjendje në vitin 2011, e shikoj pa relevancë për një konstatim të tillë, sepse ai duket i lidhur me faktin se në këtë vit subjekti ka kryer shpenzime për pagimin e këstit të fundit të apartamentit, në vlerën rreth 9.000.000 (nëntë milion) lekë, shumë e cila qartësisht ka sjellë pakësimin e gjendjes *cash* dhe përdorimin e saj për krijimin e një pasurie të paluajtshëm. Gjithashtu, në këtë vit, subjekti nuk ka deklaruar as shtesa të likuiditeteve në *cash*, duke nënkuptuar se ato janë pakësuar realisht duke humbur identitetin e tyre.

5.11. Në këtë linjë arsyetimi, vlerësoj të sjell në vëmendje edhe mënyrën se si subjekti ka deklaruar për krijimin e bonove të thesarit në vitin 2013, duke përcaktuar që në këtë deklaratë se ato janë krijuar prej të ardhurave të vitit nga pagat, deklarim të cilin nuk e ka bërë në vitet e tjera në të cilat shpjegon se ka përdorur kursimet.

5.12. Për shkak të kësaj situatë, vlerësoj se në rastin konkret pasaktësia apo paqartësia për deklarimin e burimit të krijimit të tyre në deklaratat periodike, ndërsa si është përcaktuar saktësisht në deklaratën *vetting*, duhet të interpretohet/lexohet në dritën e shpjegimeve të subjektit dhe kursimet e deklaruara deri në kohën e krijimit të bonove të thesarit duhet të

verifikohen nëse mund të justifikonin krijimin e tyre, në këndvështrim të analizës së plotë financiare të kryer për subjektin e rivlerësimit.

6. Me këtë logjikë, me ndihmën e Njësisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj, konsultova një version të analizës financiare për vitet në diskutim, kur janë krijuar bonot e thesarit, në reflektim edhe të pretendimit të Komisioneres Publike për shpenzimet e jetesës së vitit 2007, të cilat duhet të përlllogariten sipas standardit të përdorur prej Kolegjit në të gjitha çështjet që janë shqyrtuar prej tij.

6.1. Sipas kësaj analize, rezulton se për shkak të balancës negative të vitit 2007, në vlerën prej 635.303 lekësh, që superon vlerën prej 500.000 lekësh, që është deklaruar si gjendje *cash* në këtë vit prej subjektit, deduktohet se *cash*-i i deklaruar në këtë vit nuk mund të shërbejë si një burim i ligjshëm për të krijuar bonot e thesarit.

6.2. Në vitin 2008, nga analiza financiare e kryer, rezulton se subjekti ka mungesë burimi të ligjshëm në vlerën prej (-) 26.622 lekësh, e cila në vlerësimin tim mund të abstragohet për shkak të vlerës shumë të vogël dhe të mos afektojë krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar në vlerën prej 600.000 lekësh, e cila duhet të përlllogaritet e plotë për krijimin e bonove të thesarit.

6.3. Në vitin 2009, nga analiza financiare e kryer ka rezultuar se subjekti ka pasur burime të ligjshme për të krijuar gjendjen e *cash-it* të deklaruar në vlerën prej 900.000 lekësh, shumë e cila duhet të llogaritet si mundësi për krijimin e bonove të thesarit.

6.4. Në vitin 2010, kur krijohet depozita në Bono Thesari, sipas analizës së kryer në konsideratë të faktit se subjekti ka pasur gjendje likuiditeti në *cash* në vlerën prej 1.500.000 lekësh të krijuar me burime të ligjshme, një pjesë e të cilat është përdorur për krijimin e bonove të thesarit, konsideruar edhe krijimin e një shtese prej 400.000 lekësh *cash*, rezulton se subjekti ka pasur mundësi të krijojë këtë pasuri, si edhe kurimet në *cash*, duke pasur në fund të këtij viti një gjendje *cash* të akumuluar prej 1.500.000 lekësh.

6.5. Në vitin 2011, sipas analizës së kryer në këtë logjikë, rezulton se subjekti ka pakësuar gjendjen e *cash-it* në vlerën prej 1.300.000 lekësh, sepse siç e citua më sipër në këtë vit ka rezultuar të ketë shpenzuar edhe për pagimin e këstit të fundit të apartamentit, edhe për krijimin e bonove të thesarit dhe në fund të vitit rezulton se ai del me mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën prej 113.502 lekësh dhe të mbartë në vitin pasardhës shumë prej 200.000 lekësh kursime, gjendje të cilat nuk i ka pakësuar.

6.6. Në vitin 2012, subjekti i rivlerësimit, duke pasur në dispozicion gjendjen e *cash-it* në vlerën 200.000 lekë e mbetur nga pakësimi i një vit më parë, nga analiza e kryer, rezulton të ketë mundësi të krijojë me burime të ligjshme shtesën e likuiditeteve në Bono Thesari në qershor të vitit, por të ketë pamjaftueshmëri financiare për të krijuar shumë prej 700.000 lekësh, si gjendje *cash* të deklaruar në fund të vitit në DPV-në 2012, në vlerën prej 20.292 lekësh, e cila mund të abstragohet për shkak të vlerës së vogël dhe të konsiderohet pa peshë për t'u analizuar, më tej, në vlerësimin tërësor të analizës financiare.

6.7. Në vitin 2013, në të cilin subjekti deklaroi se ka shtuar bonot e thesarit nëpërmjet të ardhurave nga paga, rezulton nga analiza financiare se ajo ka pasur burime të ligjshme për t'i krijuar ato.

6.8. Në përfundim sipas kësaj analize, rezulton se subjekti i rivlerësimit gjendej në kushtet e një balance negative, për krijimin e shumës prej 3.500.000 lekësh Bono Thesari deri në vitin 2013, në vlerën prej (-) 113.502 lekësh. Bonot e thesarit janë shtuar sërish nëpërmjet depozitimeve të kryera në janar të vitit 2017, duke arritur në vlerën prej 3.860.000 lekësh deklaruar në deklaratën *vetting*, shumë për të cilën nuk kanë rezultuar problematika.

#### ***Lidhur me shpenzimet e jetesës të vitit 2007***

7. Lidhur me peshën e shpenzimeve të jetesës në vitin 2007 dhe balancën negative të krijuar, jam dakordësuar me qëndrimin e shumicës se vlera e shpenzimeve të jetesës për vitin 2007 duhet të jetë ajo e përlllogaritur sipas shkresës së përcjellë në Kolegj<sup>35</sup> prej ILDKPKI-së në vlerën totale prej 943.872 lekësh, në të njëjtën mënyrë se si ky shpenzim është llogaritur për çdo subjekt rivlerësimi të gjykuar në Kolegj. Pavarësisht kësaj përlllogaritje, siç kam arsyetuar edhe në raste të ngjashme<sup>36</sup>, nuk mund të mbetet pa vëmendje vlera e lartë e tij në këtë vit, krahasuar me vitet e tjera afër tij, si pararendëse ashtu edhe pasrendëse, në rastet kur diferenca duket se përcakton edhe nivelin e balancës negative të rezulton nga analiza financiare për subjektin e rivlerësimit. Në këtë kuptim, kam vlerësuar se vlera e balancës negative që rezulton në fund të shqyrtimit të ankimit, në vlerën prej (-) 635.303 lekësh, duhet vlerësuar edhe në këndvështrim të faktit se ajo përcaktohet si e tillë edhe për shkak të shpenzimeve të jetesës së vitit 2007, të cilat duken joproporcionale dhe të arsyeshme në raport me vitet e tjera.

#### ***Lidhur me konsiderimin e mundësisë për kursim në vitin 2003***

8. Lidhur me pretendimet e Komisioneres Publike për përlllogaritjen e gabuar të mundësisë për kursim në vitin 2003, në analizën e Komisionit, ndonëse nuk duket se ka një kërkim konkret e të matshëm, për sa i përket efektit që ky konstatim duhet të ketë në vlerësimin e kriterit të pasurisë, për shkak të peshës dhe orientimit që analiza mbi këtë element ka zënë në vendimin e shumicës, po mbaj qëndrimin tim lidhur me të.

8.1. Rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën fillestare të pasurisë gjendjet e depozitave bankare të zotëruar prej saj dhe bashkëshortit deri në muajin mars të vitit 2004, deklarim që e ka bërë edhe në vitin në vijim, kur ka deklaruar në deklaratën e pasurisë të vitit 2004, veprimet juridike e gjendjet e interesave private deri në muajin mars të viti 2005. Pra, duket se ka pasur një kuptim të gabuar mbi periudhën për të cilën kryhej deklarimi vjetor.

8.2. Duke pranuar se kjo është një mënyrë e pasaktë e deklarimit, vlerësoj se e rëndësishme në këtë kontekst është të verifikohet nëse subjekti i rivlerësimit deri në momentin e krijimit të pasurive të deklaruara, më herët në kohë se ligji e detyronte, kishte ose jo burime të ligjshme për krijimin e tyre.

8.3. Nën këtë këndvështrim, Komisioni, me të drejtë në vlerësimin tim, ka përlllogaritur në analizën financiare të kryer deri në muajin mars të vitit 2004, kohë për të cilën janë deklaruar edhe gjendjet e depozitave, të gjithë mundësinë financiare të subjektit dhe familjes, për të pasur kursime nga të ardhurat nga paga, deri në këtë datë, pavarësisht se subjekti nuk kishte bërë një

---

<sup>35</sup> Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 04.03.2019, e përcjellë nga ILDKPKI-ja në Kolegj.

<sup>36</sup> Shih mendimet e pakicës të vendimit të Kolegjit (JR) nr. 28/2022, që i përket subjektit të rivlerësimit L.D., si dhe vendimi (JR) nr. 24/2020 që i përket subjektit të rivlerësimit F.E.

deklarim të posaçëm për gjendjen e *cash*-it deri në fund të vitit 2003, sepse kjo gjendje ishte e depozituar në depozitën bankare në mars të viti 2004, të cilën subjekti e ka deklaruar që në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003. Mosdeklarimi i gjendjes *cash* në këtë vit, i cili është viti i parë i deklarimit, por aq më tepër kur kjo gjendje ka qenë e depozituar në bankë dhe e deklaruar si e tillë prej subjektit, në vlerësimin tim, nuk mund të abstragohet dhe të konsiderohet se subjekti këto depozita i ka krijuar me të ardhurat e krijuara vetëm në tremujorin e parë të vitit 2004, analizë e cila do të prodhonte atë balancë negative, artificiale në vlerësimin tim, që ka përcaktuar/parashikuar shumica në vendim.

**8.4.** Pra, duke e mbyllur këtë argument, vlerësoj se Komisionerja Publike, jo vetëm që nuk i ka dhënë peshë të dedikuar kësaj pasaktësie në ankim, por vetëm e ka evidentuar atë, edhe në vlerësimin se ajo pasaktësi duhej analizuar me diligjencën e një shkaku ankimi, sërish, për shkak të arsytimit më sipër, nuk mund të prodhojë një konkluzion negativ për subjektin.

9. Në lidhje me analizën e vitit 2014, kam ndarë të njëjtin qëndrim me shumicën se subjekti ka rezultuar me një balancë negative në vlerën prej (-) 219.864 lekësh.

### ***Në konkluzion***

10. Në konkluzion, sipas vlerësimit dhe arsytimit më sipër, subjekti i rivlerësimit rezulton me bilanc negativ si më poshtë.

**10.1.** Në vitin 2005, në vlerën prej 1.100.000 lekësh, në vitin 2007 në vlerën prej 635.303 lekësh, në vitin 2011 në vlerën prej 113.502 lekësh dhe në vitin 2014 në vlerën prej 219.864 lekësh, në total në vlerën prej (-) 2.068.669 lekësh.

**10.2.** Për sa më lart, kam vlerësuar se diferenca negative e rezultuar në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë së subjekti dominohet, *së pari*, nga vlera prej 1.100.000 lekësh e krijuar në vitin 2005, nga shitja e shtëpisë me/ose pa ambiente informale, e depozituar në bankë në ditën e hartimit të kontratës së shitjes në datën 01.02.2005 dhe deklaruar si e tillë në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2004 dhe si burim në deklaratën *vetting*. Sipas asaj që kam arsyetuar më lart, kam krijuar bindjen se burimi i kësaj shume është vërtetë produkt i këtij veprimi juridik, konsideruar jo vetëm rrethanat e faktit, por edhe sipas një vlerësimi të përgjithshëm të kriterit të pasurisë dhe jo vetëm, të subjektit të rivlerësimit. Pavarësisht këtij fakti ajo me të dejtë nuk është përfshirë në analizën financiare, pasi rezulton e provuar mungesa e pagimit të detyrimeve tatimore. *Së dyti*, analiza ndikohet në një masë relativisht të rëndësishme edhe nga niveli i lartë i shpenzimeve të jetesës në vitin 2007, që siç e përmenda edhe më lart rezulton të jetë dukshëm i ndryshëm dhe jo në koherencë me shpenzimet e viteve afër tij, element që sugjeron për një kosto në dukje të fryrë të këtyre shpenzimeve në këtë vit, dhe që rrezikon një vlerësim jo objektiv të tyre, veçanërisht në situata të ngjashme kur ato luajnë një rol domethënëse në ekonominë familjare e në balancat financiare të saj.

**10.3.** Nën dritën e këtyre elementeve dhe në këndvështrim të një vlerësimi tërësor të pasurive dhe shpenzimeve për jetesë të evidentuara për subjektin e rivlerësimit, të cilat rezultojnë të jenë modeste dhe që nuk sugjerojnë për një sjellje abuzive me detyrën, në konsideratë edhe të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, kam vlerësuar se ato nuk duhet/mundet të përcaktojnë se niveli i besueshmërisë në vlerësimin e pasurisë së subjektit është i



pamjaftueshëm dhe, për pasojë, as të diktojnë vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

11. Në këto kushte, mbështetur në analizën dhe konkluzionet e mësipërme, kam votuar për lënien në fuqi të vendimit nr. 729, datë 10.01.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**GJYQTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*